

*Guidë
arkeologjike
e Kosovës*

Guidë arkeologjike e Kosovës

Botues:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Instituti Arkeologjik i Kosovës

Autor:

Milot Berisha

Këshilli Redaktues:

Vjollca Aliu, drejtoreshë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore - MKRS

Kemajl Luci, arkeolog, kustos i lartë në Muzeun e Kosovës

Dr.sc. Enver Rexha, drejtor në Institutin Arkeologjik të Kosovës

Dr.sc. Shafi Gashi, arkeolog në Institutin Arkeologjik të Kosovës

Mr.sc. Premtim Alaj, arkeolog në Institutin Arkeologjik të Kosovës

Dip.sc. Luan Gashi, antropolog në Institutin Arkeologjik të Kosovës

Përpilimi i hartave:

Faik S. Berisha

Design:

www.xhad.net

Prishtinë 2012



Të nderuar miq,

Guida që ju tashmë keni në duar shënon një hap tejët domethënës drejt dokumentimit dhe prezantimit të trashëgimisë sonë arkeologjike. Kjo guidë është një përmbledhje e shkurtër, por mjaft e rëndësishme që synon të ofrojë shpjegime për disa dhjetëra lokalitete arkeologjike, nga rreth 400 gjithsej të evidentuara në territorin e Kosovës deri më tani dhe të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të Republikës së Kosovës. Si e tillë, guida do të shërbej si një informator për lokalitetet e përzgjedhura e ndoshta më të rëndësishmet të dokumentuara në Kosovë. Kjo i dedikohet të gjitha grupmoshave që janë kureshtarë për të njohur trashëgiminë e pasur arkeologjike të vendit tonë. Guida është e përgatitur në rrjedhë kronologjike, duke filluar nga parahistoria e deri në mesjetë.

Trashëgimia arkeologjike e Kosovës e evidentuar deri më sot, paraqet një thesar të çmuar të vendit tonë. Potenciali arkeologjik identifikuar gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar është dokumentuar përmes gjurmimeve të ndryshme arkeologjike. Hulumtimet kërkimore arkeologjike u zhvilluan edhe gjatë dekadës së fundit në formën e sondazheve testuese, gjurmimeve sistematike, përnjohjeve dhe së fundi edhe përmes studimeve ndërdisiplinare gjeofizike, arkeobotanike dhe arkeometalurgjike.

Këto kërkime të ndërthurura shkencore janë vënë në funksion të njohjes, analizimit dhe prezantimit të begatë të vlerave arkeologjike të Kosovës. Këto dëshmi arkeologjike pasqyrojnë gjurmë, mbetje, rrënoja e artefakte të civilizimeve të kaluara, si të popullsisë autoktone, ashtu

dhe të civilizimeve lindore dhe perëndimore, të dokumentuara në hapësirë dhe në kohë të përcaktuar.

Falë punëve studimore disa dekadëshe të arkeologëve vendorë, posaçërisht në dhjetëvjeçarin e fundit, përmes bashkëpunimit me arkeologët nga Shqipëria, Franca dhe sidomos me ardhjen e specialistëve të fushave ndërdisiplinare arkeologjike të kolegëve nga Gjermania, Kosova tashmë mund të prezantojë trashëgiminë jashtëzakonisht të pasur e të larmishme arkeologjike, brenda dhe jashtë vendit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të vazhdojë të mbështesë ekspeditat me karakter përnjohës, hulumtimet, studimet arkeologjike e në veçanti botimet përmes të cilave do të prezantohet dhe promovohet trashëgimia kulturore arkeologjike e Kosovës.

Memli KRASNIQI

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Përmbajtja

Hyrje	7	Periudha Romake	57
Harta e Republikës së Kosovës	9	Municipium D.D. (Dardanorum)	61
Neoliti	11	Vindenis	62
Vlashnje	13	Pestovë	63
Runik	17	Poslishtë	64
Varosh	19	Staradran	65
Zhitkoc dhe Karagaç	20	Cërcë	66
Vallaç	21	Kllokot-Vërban	67
Reshtan	22	Paldenicë	68
Barilevë	24	Municipium Ulpiana	69
Bardhosh	25	Uglar-Statio Viciano	72
Tjerrtorja-Prishtinë	26	Nerodime e Poshtme	73
Fafos-Mitrovicë	28	Çifllak	74
Surkish	30	Nikadin	75
 		Periudha e Antikitetit	
Sopata guri të neolitit	31	të Vonë dhe Mesjeta	77
 		Vrellë	79
Periudha e metaleve	33	Banja e Malishevës	80
Gadime e Epërme	35	Kalaja e Harilaqit	81
Hisar	36	Kalaja e Pogragjës	82
Gllarevë	39	Kalaja e Korishës	
Boka e Përçevës	41	me Kishën Paleokristiane	83
Rogovë	42	Kalaja e Vuçakut	85
Korishë	44	Kalaja e Strocit	85
Bërnice e Poshtme	45	Kalaja e Llapushnikut	86
Ponoshec	46	Kalaja e Llanishtës	86
Gjinoc	47	Kalaja e Dubocit	87
Bellaçec	48	Kalaja e Topanicës	87
Fshej	49	Suka e Cërmjanit	88
Llashticë	50	Zatriq	89
Shirokë	51	Kalaja e Veletinit	90
Lubozhdë	52	Graboc	91
Banja e Pejës	53	Matiqan	92
Prizren, gjetje të veçanta rasti	55	Novobërdë	93
Kamenicë, gjetje unike rasti	56	Kalaja e Prizrenit	94
		Muzeu i Kosovës	96
Hartat:			
Lokalitetet e Periudhës Neolitike	99		
Lokalitetet e Periudhës Eneolitike	101		
Lokalitetet e Periudhës së Bronzit	103		
Lokalitetet e Periudhës së Hekurit	105		
Lokalitetet e Periudhës Romake	107		
Lokalitetet e Periudhës të Antikës së Vonë dhe Mesjetës	109		



Hyrje

Pozita e favorshme gjeostrategjike si dhe burimet e pasura natyrore ishin ideale për zhvillimin e jetës që nga periudhat parahistorike, të dëshmuara nga gjurmët e qindra lokaliteteve arkeologjike të zbuluara dhe të identifikuara anekënd Kosovës, që me krenari paraqesin trashëgiminë e begatshme arkeologjike të vendit tonë.

Kjo guidë e shkurtër e trashëgimisë arkeologjike na shoqëron nëpër lashtësinë e Kosovës dhe është ideuar në mënyrë që të ofrohen vetëm informacionet bazike të disa prej qendrave të përzgjedhura arkeologjike të Kosovës.

Sigurisht që numri i lokaliteteve me potencial arkeologjik është gjithnjë në rritje, kjo edhe nga zbulimet dhe hulumtimet që po zhvillohen anekënd Kosovës, por edhe nga gjurmët e shumta sipërfaqësore të evidentuara, e të cilat na ofrojnë një pasqyrë të re për lashtësinë e vendit tonë.

Gjurmët më të hershme të dokumentuara në territorin e Kosovës i takojnë kohës së gurit, gjegjësisht ka indikacione se edhe mund të ketë pasur vendbanime shpellore si në shpellën e Radacit, fare pranë vendburimit të Drinit të Bardhë, pastaj indikacione ka edhe në shpellën e Gërçarit të Vitisë, atë të Demës e të Karamakazit të Pejës etj.



Megjithatë, akoma nuk është konfirmuar jetesa gjatë periudhës së paleolitit apo kohës së vjetër të gurit. Andaj, derisa nuk të konfirmohen argumentet e popullimit të njeriut të paleolitit dhe mezolitit, njeriu i neolitit, respektivisht vendbanimet neolitike merren si kohë fillestare kronologjike e popullimit të vendit tonë. Që nga kjo periudhë kohore e deri më sot, vendi ynë ishte populluar dhe gjurmët e aktiviteteve të shoqërive parahistorike, antike e mesjetare janë evidente pothuajse në gjithë territorin e Kosovës, derisa, në disa site arkeologjike ka gjurmë të vendbanimeve shumështrësore që shumë qartë reflekton vazhdimësinë e jetesës ndër shekuj.

Guida që prezantohet këtu nuk e ka karakterin e një udhërrëfyesi të turizmit kulturor, por, për më tepër, meqenëse ngritja e infrastrukturës për zhvillimin dhe promovimin e arkeoturizmit dhe të parqeve arkeologjike është shumë e kushtueshme dhe nevojitet kohë dhe ekspertizë, atëherë kjo guidë të paktën ofron një informacion të përgjithshëm për disa nga qendrat më të rëndësishme arkeologjike të Kosovës.

Materialet e mbledhura për përgatitjen e guidës janë grumbulluar dhe janë shfrytëzuar qoftë nga publikimet apo raportet e mëparshme si dhe nga fondet arkivore të Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe të Muzeut të Kosovës, por edhe nga Baza e të Dhënave të Trashëgimisë Arkeologjike të Kosovës.

Harta e Republikës së Kosovës

Legjenda

Kufij shtetërorë

Kufij administrativë

Kryeqytet

Qytet

Aeroporti Ndërkombëtar

i Prishtinës "Adem Jashari"

Autostrada "Ibrahim Rugova"

Rrugë magjistrale

Rrugë dytësore

Hekurudhë





Neoliti

Klima e ngrohtë dhe e lagësht e holocenit që pasoi pas shkrirjes së fundit të akullnajave, solli ndryshime në natyrë dhe u reflektua te njeriu, por edhe në florën dhe faunën e ambientit të përgjithshëm të mjedisit jetësor. Ky stabilizim klimatik ndikoi edhe në ndryshimin e jetës dhe veprimtarisë së njeriut. Shoqëria njerëzore tani merr karakter të shoqërisë së organizuar dhe reflektohet në ngritjen e vendbanimeve të përhershme, këto të ndërtuara në vende të thata, mbi brigje lumenjsh dhe rrafshnalta të plleshme. Njeriu tani zotëron gurin dhe e përdor për përpunimin e armëve, veglave, por edhe në arkitekturën primitive.

Karakteristikat kulturore të periudhës së gurit të ri (neolitit) bazohen në dokumentimin arkeologjik dhe emërohet pikërisht nga përdorimi i gurit (neo- e re, Lithos-gurë), andaj e njohim si civilizimi neolitik apo koha e gurit të ri. Gjatë kësaj periudhe ndodhin zhvillime

madhore që ndikojnë në mënyrën e jetesës si: zhvillimi i punimeve bujqësore, zbutja apo familjarizimi (domestikimi) i kafshëve që tani njihen si kafshë shtëpiake, dhe përpunimi i qeramikës; të gjitha këto profesione të reja sollën zhvillim dhe prosperuan civilizimin njerëzor.

Njeriu tashmë e lë gjuetinë në plan të dytë që njëherësh ndikon nga kalimi i jetës nomade në gjysmë nomade. Kultivimi i drithërave vihet në plan të parë dhe tokat punohen me veglat e punuara nga guri, kockat, por edhe nga druri. Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore, roli i gruas kalon në plan të parë, duke u marrë me punët për tjerre- endje, punimin e enëve të qeramikës si dhe përkujdesen për ambientin e banimit, fëmijët, ushqimin dhe zbutjen e kafshëve. Të gjitha këto punë bëhen nga gratë neolitike.

Figurinat antropomorfe zbuluar anekënd botës si dhe në vendin tonë, e dëshmojnë këtë argument ku në pjesën dërrmuese të këtyre figurinave antropomorfe të punuara në formë të skematizuar, në shumicën e rasteve paraqesin trupin e femrës. Burimet kryesore në jetën ekonomike të neolitit janë agrikultura, prodhimtaria e veglave dhe qeramikës, rritja e bagëtisë, por në një masë edhe gjuetia dhe peshkimi. Andaj edhe vendbanimet janë ngritur aty ku kishte predispozita dhe burime natyrore. Pjesa dërrmuese e vendbanimeve parahistorike neolitike të humtuara në vendin tonë hedhin dritë mbi faktin se janë punuar kryesisht nga materialet që gjendeshin në afërsi të mjedisve dhe lokaliteteve ku janë ngritur.

Vendbanimet neolitike konstruktoshin kryesisht nga kasollet-shtëpitë e vogla me shtylla drunjsh e me thupra të thurura e të lyera me baltë të përzier me byk kashte, derisa çatitë ishin të mbuluara me kallam dhe me kashtë thekre. Edhe pse në mesin e arkeologëve gjithandej ka perceptime të ndryshme rreth datimit të neolitit, mund të thuhet se periudha kohore nga 6500-3500 p.e.s. duhet të merret si një shtrirje relative reale e kësaj periudhe për territorin e Ballkanit.

Arti shpellor dhe arti shkëmbor është dëshmuar edhe në vendin tonë, që kanë shërbyer si strehë e përkohshme, por edhe një formë e faltoreve prehistorike apo vende kulturi ku i është falur dhe lutur Zotave të ndryshëm të botës pagane. Kulturi kryesor i takon hyjneshës së njohur si hyjnesha mëmë. Kjo edhe dëshmi se figura e nënës (gruas) zë vend të rëndësishëm, meqenëse ajo udhëheq shtëpinë, kujdeset për ngritjen dhe ruajtjen e familjes, angazhohet në procesin e zhvillimit kulturor dhe ekonomik si dhe organizimin shoqëror të familjes. Pozita e tillë njëherësh njihet si periudha e matriarkatit që ishte karakteristikë dalluese e neolitit.




■ 4

Lokaliteti arkeologjik, përkatësisht vendbanimi shumështrësor i Vlashnjes gjendet në sipërfaqen e sheshtë të një tarrace shkëmbore (335 metra lartësi mbidetare) në krahun e djathtë të rrugës Prizren-Zhur, rreth 6 km në perëndim të Prizrenit

Në këtë lokalitet është dëshmuar vazhdimësia e jetës gjatë disa periudhave kohore si neolit i hershëm (kultura e Starçevës), neolit i vonë dhe i mesëm (kultura e Vinçës), eneolit (periudha e bakrit), periudha e bronzit, epoka e hekurit, periudha helenistike si dhe periudhat e antikitetit të vonë dhe të mesjetës së hershme. Materiali arkeologjik i zbuluar në këtë lokalitet hulumtuar në disa sezona që pas viteve dy mijë të mileniumit tonë, nxori në pah fragmente të shumta të enëve nga argjila e pjekur, vegla pune nga guri, stralli dhe kocka, si dhe zbuku-

■ 5



■ 6



rime dhe objekte utilitare, monedha etj. Gjatë antikitetit të vonë, tarraca e sheshte e njohur me toponimin *Gradishta e Vlashnjës*, fortifikohet me mure të konstruktura, karakteristike e rindërtimeve të periudhës së sundimit të perandorit Justinian, areal ky që përfshinte një sipërfaqe prej rreth 2 hektarësh, dhe me siguri që nga këtu është mbikëqyrur segmenti rrugor romak *Via Lissus-Naissus* (Lezhë-Nish), që besohet të ketë kaluar fare pranë kësaj qendre arkeologjike.

Fragmente të ndryshme të qeramikës me pikturim me vija gjeometrike janë dëshmuar këtu. Poashtu edhe thika stralli, këto të epokës së neolitit, gjegjësisht të Kulturës së Starçevës, mileniumi i gjashtë, p.e.s.

- Fig. 4. Pamje e taracës, e vendndodhjes së lokalitetit arkeologjik të Vlashnjës.
- Fig.5. Harta e vendndodhjes
- Fig.6. Ortofoto e lokalitetit të Vlashnjës
- Fig. 7. Fragment qeramike pikturuar me vija gjeometrike
- Fig. 8. Thikë stralli
- Fig. 9. Pamje të disa kuadrateve të gërmuara në Vlashnje



■ 7



■ 8





■ 10

Figurina të ndryshme antropomorfe janë zbuluara gjatë gërmimeve të dekadës së parë të mijëvjeçarit të dytë (2002-2010), nga të cilat spikatet një figurinë antropomorfe, një ekzemplarë tipik për Kulturën e Starçevës. Periudha e Neolitit të Hershëm. Mileniumi i gjashtë p.e.s.



■ 11

Gjithashtu janë gjetur figurina zoomorfe zbuluar në Vlashnje, këto të periudhës së Neolitit të Hershëm, gjegjësisht të kulturës Starçevo, Mileniumi i gjashtë p.e.s

Zgjon kureshtjen një enë nga argjila e pjekur, me dekorim, poashtu zbuluar në këtë lokalitet, tipike për Kulturën e Vinçës, Mileniumi i tretë p.e.s.



■ 12

Janë gjetur edhe enë të ndryshme tryeze nga argjila e pjekur, të Periudhës së Bronzit.



■ 13



■ 14

■ Fig. 10 Koleksion i figurinave në formë njerëzore nga argjila e pjekur dhe në djathtë foto e zmadhuar e njerës nga këto figurina. (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 11. Figurinë nga argjila e pjekur e ornamentuar në formë të një bualli. (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 12. Enë në formë bikonike e zbukuruar me incizim dhe shpim me instrument (e restauruar). (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 13. Tas një vegjak e periudhës së Bronzit të Vonë. (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 14. Enë dyvegjake e periudhës së Bronzit të Hershëm (Instituti Arkeologjik i Kosovës)



■ 15

Piktura shkëmbore e Vlashnjes, gjegjësisht Guva e Mrrizit me simbolin e pikturuar të spirales paraqet një vepër të botës artistike-shpirtërore të banorëve prehistorikë të këtij lokaliteti (vend kult). Guva shkëmbore e këtij pikturimi ndodhet rreth 1,5 km në perëndim të vendbanimit të Vlashnjes në fshatin fqinj Kobaj.

Nga shumë gjetje të periudhave të ndryshme historike zbuluar në Vlashnje, spikat një monedhë argjendi e emetuar në vitin 55 p.e.s. Monedha ka një peshë prej 3.72 gramë dhe ishte vënë në qarkullim për nder të edilit të Kretës, Gnaeus Plancius.



■ 16

■ Fig. 15. Simboli i pikturuar i spiraleve dyshe

■ Fig. 16. Monedha e argjendët e Vlashnjes.
(Instituti Arkeologjik i Kosovës)



■ 17


Runik

Lokaliteti neolitik i Runikut ndodhet në komunën e Skenderajt, në fshatin Runik, e pozicionuar në pllajën e Drenicës, rreth 25 km në jugperëndim të Mitrovicës dhe rreth 10 km në veriperëndim të Skenderajt dhe gjendet në aksin rrugor që lidh Skenderajn me Istogun. Këtu është dëshmuar një nga vendbanimet më të hershme neolitike të Kosovës që i takon Kulturës së Starçevës, përkatësisht mileniumit të gjashtë p.e.s. dhe pasqyron një qytetërim të zhvilluar të kohës së gurit të ri.

Ky lokalitet arkeologjik është hulumtuar gjatë viteve 1966-68 dhe sërish në vitin 1984. Hulumtime këto me karakter sondazhi të shtrira në rreth 35 parcela private të lagjes *Dardania*, me ç'rast u zbuluan mbetje dhe fragmente të shumta qeramike të periudhës neolitike (6500-3500 p.e.s.) gjegjësisht u dëshmuar kultura e Starçevës dhe ajo e Vinçës.

Hulumtime më të avancuara u zhvilluan edhe gjatë muajit Mars të vitit 2010, këto të karakterit tëurveut sipërfaqësor apo njohur si prospektim apo incizime gjeofizike me magnetometër, të cilat u zhvilluan në dy pjesë të këtij areali arkeologjik, që së bashku kapte një sipërfaqe prej rreth 10000 metra katrorë.

Ky vendbanim i hapur i periudhës së gurit karakterizohej nga kasollet e ndërtuara me trarë druri të lidhura dhe pa nivele të dys-hemeve.



■ Fig. 17. Enë sferike e punuar nga argjilla e pjekur dhe e zbukuruar me teknikën *impresso*, zbuluar në Runik të Skenderajt (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 18. Vendndodhja e Runikut në Komunën e Skenderajt



■ 19

■ 20



■ 21



■ 22

■ Fig. 19 & 20. Vazo zbuluar në Runik të Skenderajt, Kultura e Starçevës, (Muzeu i Kosovës).

■ Fig. 21. Vazo neolitike nga Runiku. (Muzeu i Kosovës).

■ Fig. 22. Okarina, (Muzeu i Kosovës).

Nga materiali i lëvizshëm arkeologjik zbuluar në këtë vendbanim neolitik dominojnë fragmente të qeramikës monokrome me lustër të kuqe, si dhe enë të zbukuruar në teknikën barbotine dhe impreso, por ka edhe qeramikë të pikturuar dhe me motive lineare e gjeometrike. Gjithashtu këtu janë dëshmuar edhe figurinat antropomorfe e tavolina (altar) kulturi

Nga enët e ndryshme zbuluar në Runik, vëmendjen e tërheq një vazo e punuar në argjilë dhe e pjekur, e lyer me ngjyrë okër dhe e pikturuar me ngjyrë të zezë të errët, e zbukuruar në formë të spirales me motiv të pëllëmbës së dorës.

Nga zbulimet e shumëllojshme në këtë lokalitet reprezentativ neolitik, veçohet një artefakt unik jo vetëm për territorin e Kosovës por edhe për rajon.

Ky ekzemplar i punuar nga argjila e pastruar mirë dhe e pjekur, me një lartësi prej vetëm 8 cm dhe e vrimuar si në boshtevrima për gishtërinjë poashtu dhe në aksin më të lartë-pipëza, kishte shërbyer si një instrumenti frymor muzikor, një lloj fyelli neolitik.

Instrumenti ishte pagëzuar me emrin Okarina e Runikut dhe është instrumenti më i hershëm muzikor i zbuluar në Kosovë. Tingujt dhe vibrimet e ngrohta të lëshuara nga ky instrument, na transmetojnë botën e pasur shpirtërore e muzikore të njeriut neolitik të kësaj treve.




■ 23

Varosh

Lokaliteti neolitik i identifikuar i Varoshit ndodhet në komunën e Ferizajt, gjegjësisht vetëm 2 km në jug, juglindje të këtij qyteti, në fshatin me po të njëjtin emër.

Megjithëse këtu akoma nuk janë zhvilluar sondazhe arkeologjike, në disa raste kanë dalë gjurmë të fragmenteve të ndryshme të qeramikës neolitike, kryesisht zbuluar rastësisht gjatë punimeve bujqësore të tokave; material ky në pjesën më të madhe i lëvizshëm arkeologjik që dëshmon gjurmët e një vendbanimi të hapur tipik neolitik të të dy kulturave, si të Starçevës ashtu dhe të Vinçës.

Gjatë vitit 2011, në disa parcela të këtij lokaliteti arkeologjik u zhvilluan disa incizime gjeofizike, të cilat reflektuan struktura të nëndeshme që mbase mund të indikojnë gjurmë të “banesave” neolitike.



■ Fig. 23. Figurinë antropomorfë zbuluar në Varosh. Kultura Starçevë, Periudha e Neolitit të Hershëm. Mileniumi i gjashtë p.e.s. (Gjetje rasti: Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 24. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik të Varoshit në komunën e Ferizajt.


Zhitkoc dhe Karagaç

■ 25



Lokaliteti neolitik i Zhitkocit ndodhet në komunën e Zveçanit, gjegjësisht rreth 3 km në veri të qytezës së Zveçanit, në një rrafshinë afër stacionit të trenit të Zhitkocit. Këtu gjatë disa sondazheve të zhvilluara arkeologjike të vitit 1958, fare pranë brigjeve të lumit Ibër, janë dëshmuar gjurmët e një vendbanimi tipik neolitik të të dy kulturave, si asaj më të hershme të Starçevës dhe më të vonshme të Vinçës.

Lokaliteti arkeologjik fqinj Karagaç shtrihet në një tarracë të ulët përgjatë rrjedhjes së lumit Ibër. Është hulumtuar gjatë viteve 1955 dhe 1960. Rezultatet arkeologjike reflektuan se përkaj brigjeve të lumit, gjatë neolitit të mesëm, është formuar vendbanimi që në pjesën më të madhe përbëhej nga kasolle gjysmë të groposura në formë elipsoide dhe të mbrojtura me hendeqe. Brenda tyre dhe përreth janë zbuluar një sasi e konsiderueshme e fragmenteve të qeramikës karakteristike për Kulturën e Starçevës. Në po të njëjtin vend është ngritur një vendbanim me shtëpi të punuar nga thupra të gërshetuara dhe të lyera me baltë. Në bazë të enëve të qeramikës dhe figurinave antropomorfe, ky vendbanim lidhet me fazën e hershme të kulturës së Vinçës. Përveç materialit neolitik, në po këtë areal, kanë dalë në pah edhe mbetje të një vendbanimi dhe nekropoli më të vonshëm të periudhave të bronzit dhe të hekurit, që flet qartë për vazhdimësinë e jetës gjatë tërë periudhës së gjatë të parahistorisë.



■ Fig. 25. Figurinë antropomorfe zbuluar në Zhitkoc. Kultura Starçevë, Periudha e Neolitit të Hershëm. Mileniumi i gjashtë p.e.s. (Muzeu i Mitrovicës)

■ Fig. 26. Harta e lokalizimit të dy lokaliteteve neolitike, Zhitkoc dhe Karagaç në komunën e Zveçanit.



■ 27



■ 28

Vallaç

Fshati Vallaç gjendet në veri të Zhitkocit- Karagaçit dhe fare pranë grykërrjedhjes së lumit Ibër, e pozicionuar mbi një ngritje të njohur si Kërshi i Vallaçit. Është hulumtuar pjesërisht në vitet 1955 dhe 1957. Në shtresën kulturore të trashë 1.8 metër janë zbuluar gjurmë të vendbanimit me kasolle banimi të thurura dhe të mbrojtura me hendeqe përreth.


Nga materiali i shumëllojtë arkeologjik zbuluar këtu, veçohen një sasi e konsiderueshme e figurinave antropomorfe dhe zoomorfe, të punuara dhe të formësuar me aftësi dhe imagjinatë të bujshme, këto karakteristike për periudhën e vonë të Kulturës së Vinçës, e njohur si Vinça C.

Karakteristikë tjetër është se këtu poshtë shtresave neolitike, janë hasur edhe gjurmë të periudhës së hekurit të vonë, të një vendbanimi të fortifikuar, dëshmuar nga ndërtimi i një muri të thatë ledhi, që mbronte hyrjen e vendbanimit.

■ Fig. 27. Figurinë antropomorfe

■ Fig. 28. Figurinë nga terrakota e një centauri. Të dy artefaktet janë zbuluar në Vallaç. Kultura Vinçe, Periudha e Neolitit të Vonë.


■ Fig. 29. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik në Vallaç në komunën e Zveçanit





Reshtan

Reshtani është një vendbanim neolitik i pozicionuar në prapatakën e Suharekës (në aksin ku sot kalon autostrada Suharekë-Prizren). Ky lokalitet është hulumtuar në vitet 1966/67, gërmime të cilat kishin karakter sondazhi. Gjatë muajit mars të vitit 2011, një sipërfaqe e konsiderueshme e këtij lokaliteti është incizuar me instrumente gjeofizike dhe po gjatë këtij viti janë zhvilluar gërmime me karakter shpëtimi që kapte një sipërfaqe prej 250 m². U evidentuan tri horizonte banimi të neolitit të mesëm dhe fillimit të neolitit të vonë (4200-3800 p.e.s.). Në shtresën kulturore të trashësisë 2 metra, janë zbuluar gjurmë të tri horizonteve të banimit të shtëpive me gjithë vatër dhe hendeqe. Në bazë të fragmenteve të qeramikës së zbuluar, si në formë, ashtu dhe në ornamentikë, është konstatuar se krahas Kulturës së Vinçës, kemi një prani shumë të fuqishme edhe të kulturës adriatikase të Danilos.



- Fig. 30. Pamje e sektorit A (gërmimshpëtimi, viti 2011, IAK)
- Fig. 31. Bukranioni, mbrojtësi i banesave neolitike, zbuluar *in situ* (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 32. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik në Reshtan, komuna e Suharekës (Theranda).



■ 33



■ 34



■ 35

■ Fig. 33. Enë-vazo kulturi (Riton) Kultura e Danilos, zbuluar në Reshtan (Instituti Arkeologjik i Kosovës).

■ Fig. 34. Fragment ene me tipare të fytyrës së njeriut zbuluar në Reshtan (Instituti Arkeologjik i Kosovës).

■ Fig. 35. Enë dy vegjake nga argjila e pjekur zbuluar në Reshtan (Instituti Arkeologjik i Kosovës).



■ 36




■ 37

Barilevë

Lokaliteti neolitik i Barilevës gjendet në fshatin me po të njëjtin emër, e pozicionuar në arealin e njohur si Arat Kovaçe, tokë punuese e cilësisë së lartë. Njoftimet e para për vlerën e këtij lokaliteti i kemi që në vitet '60, me rastin e gjetjes së rastësishme të një figurine shumë të veçantë e të dallueshme për kulturën vinçase.

Edhe ky lokalitet gjendet afër rrjedhjes së lumit (lumi Llap) që qartazi na ofron një pasqyrë të kohës se vendbanimet neolitike zakonisht kanë qenë të vendosura në zona pranë lumenjve dhe në toka të pasura me burime ujore.

Gjatë vitit 2011, këtu u zhvilluan incizime gjeofizike me magnetometër, në një sipërfaqe të konsiderueshme; rezultate këto që konfirmuan potencialin e madh arkeologjik të këtij lokaliteti të hapur neolitik.



■ 38

■ Fig. 36. Figurinë nga argjila e pjekur (Terrakotë), në pozitë të ulur. Lartësia: 26.5 cm. Kultura e Vinçës. Gjetje rasti. (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 37. Terrakotë në formë të kokës antropomorfe zbuluar në Barilevë. Kultura e Vinçës. Gjetje rasti. (Instituti Arkeologjik i Kosovës).

■ Fig. 38. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik në Barilevë, komuna e Prishtinës




Bardhosh

Bardhoshi gjendet në veri, në dalje të Prishtinës, në krahun e majtë të rrugës për Podujevë. Lokaliteti neolitik (Koha e Vinçës) i Bardhoshit është identifikuar rastësisht në vitin 2002, me rastin e hapjes së themeleve për ndërtimin e një shtëpie banimi dhe anekseve shoqëruese.

Gërmimshpëtimi i kryer në këtë lokalitet dëshmoi gjurmë të një vendbanimi rrafshinor me disa ambiente banimi me vatër dhe vegla pune, objekte dhe fragmente të qeramikës. Këtu u zbulua një sasi e konsiderueshme e figurinave antropomorfe të terrakotave tipike për variantin kosovar të Vinçës, gjegjësisht, të ‘stilit’ të Prishtinës.

■ Fig. 39. Figurina antropomorfe, nga Bardhoshi, Kultura e Vinçës. (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 40. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik në Bardhosh, komuna e Prishtinës.



Tjerrtorja-Prishtinë

Lokaliteti neolitik i njohur me emrin *Tjerrtorja* është zbuluar rastësisht, me rastin e ndërtimit të fabrikës së përpunimit dhe të produkteve tekstile *TJERRTORJA*, gjatë viteve '50, andaj dhe është emërtuar me këtë emërtim, pra në bazë të vendgjetjes.

Ky lokalitet gjendet brenda arealit të qytetit të Prishtinës, në lagjen Kalabria (Emshir). Gjurmët e vendbanimit neolitik të evidentuar këtu, materiali i pasur dhe i shumëllojhtë neolitik si dhe duke u bazuar nga disa nga gjetjet e figurinave, statujave dhe kokave antropomorfe të terrakotave (të punuara nga argjila e pjekur), të zbuluar në këtë areal të Prishtinës, e që i takojnë periudhës së neolitit të vonë gjegjësisht kultura e Vinçës, prezantojnë dy tipare të mrekulueshme: atë të artit dhe simbolizmit parahistorik.


Në lidhje me këtë, skulpturat e terrakotave madhështore të kësaj kohe të zbuluara në Prishtinë (1951, 1955-56 dhe 1962), ku spikatet figurina monumentale e Hyjneshës në Fron, arkeologu eminent anglez, Profesor Renfrew i vendos në një grup të veçantë dhe të dallueshëm duke i quajtur "Stili i Prishtinës", sepse përveç realizimit të lartë dhe cilësor artistik, figurinat dallohen edhe për nga veçoritë dhe tiparet e tjera, ku spikatin kokat të modeluara shumë me kujdes, hundët e theksuara dhe nga sytë e mëdhenj e konveks (në formë të bajameve). Për



■ 41



■ 42



■ 43

■ Fig. 41. Hyjneshë në Fron (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 42. Qeramikë e pjekur me motiv të gjarprit të mbështjellur, zbuluar në lokalitetin e Tjerrtores. (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 43. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik të Tjerrtores' në lagjen Emshir të qytetit të Prishtinës

me tepër, njëra nga prehistorianët më eminentë botërorë, profesore-sha tashmë e ndjerë e arkeologjisë, Maria Gimbutas, ka argumentuar se hyjnitë individualisht mund të shihen në mesin e figurinave të zbuluara në Prishtinë, gjithnjë duke iu referuar Hyjneshës në Fron, si ekzemplar i veçantë.

Hyjnesha në Fron është njëra nga artefaktet më të çmu-eshme arkeologjike të Kosovës dhe gjendet e ekspozuar në sallën e ekspozitës së përhershme arkeologjike në Muzeun e Kosovës.

Terrakota paraqet figurën e një hyjnie femërore gjegjësisht reflekton kultin e idhullit të nënës së madhe. Figurina antropomorfe në dukje paraqitet me një qëndrim stoik, në pozitë të ulur e me trupmbajtje të drejtë; me dy duart e vendosur në bel, dhe e vendosur mbi një fron. Koka ka formë pesëkëndore me tipare të mprehta të konturave të fytyrës, me një hundë të theksuar dhe sy në formë të bajames. Në kokë paraqitet diadema në formë të një gunge kurrizore gjysmërrethore.

Kjo figurinë është tipike për variantin kosovar të kulturës së Vinçës, gjegjësisht mund të thuhet se i takon stilit të veçantë të Prishtinës. Statueta nga terrakota datohet në periudhën kronologjike rreth mileniumit të katërt-të tretë p.e.s.

Muzeu i Kosovës e ka përvetësuar shenjën grafike të Hyjneshës si logo por njëheri është shndërruar edhe në simbol të kryeqytetit.



■ Fig. 44. Katër koka antropomorfe të terrakotës zbuluar në vendbanimin neolitik të Tjerrtores. (Muzeu i Kosovës).

■ Fig 45. Ortofoto e arealit dhe ish fabrikës së tjertrtores






■ 46

Fafos-Mitrovicë

Lokaliteti arkeologjik i njohur me emrin Fafos gjendet në periferi të Mitrovicës, në arealin e fabrikës së dikurshme të fosfateve (FAFOS). Është hulumtuar në periudhën kohore në vitin 1955 dhe në vitin 1961. Gjithsej është hulumtuar një sipërfaqe prej rreth 1200 metra katrorë ku janë zbuluar gjurmë të dy vendbanimeve (rreth 200 metra larg njëra-tjetrës) të kulturës së Vinçës.

Lokaliteti më i vjetër (Fafos I) përbëhej nga vendbanimi gjysmë i groposur nën dhe, me shtëpi në formë të kasolleve, kurse vendbanimi më i ri (Fafos II) përbëhej nga shtëpitë-kasolle të renditura njëra krahas me tjetrën, të cilat kanë pësuar nga ndonjë zjarr i madh. Në dy vendbanimet janë zbuluar objekte të ndryshme për përdorim të përditshëm si objekte kulti, vazo ritualesh, altar dhe figurina antropomorfe.



■ 47

- Fig. 46-46a. Kapak prozopomorf të punuara nga argjila e pjekur, i stilizuar me motive dhe me ornamentim të shkëlqyeshëm artistik, zbuluar në Fafos. (Muzeu i Kosovës).
- Fig. 47. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik të Fafosit.
- Fig. 48. Figurinë terrakote në formë antropomorfe me element të theksuar të atributiveve femërore, zbuluar në Fafos. (Muzeu i Kosovës).
- Fig. 49. Tavolinë apo altar kulti me tre këmbë, punuara nga argjila e pjekur, zbuluar në Fafos. (Muzeu i Kosovës).
- Fig. 50. Figurinë e kentaurit (Muzeu i Kosovës).



■ 48



■ 46a



■ 49




■ 50



Surkish

Lokaliteti i identifikuar neolitik i Surkishit gjendet e pozicionuar vetëm pak kilometra në jug-jugperëndim të qytezës së Podujevës (Besianës), në fshatin me po të njëjtin emër, në parcelën e njohur me toponimin Gumurishtë.

Nuk dihet madhësia e sipërfaqes dhe as shtresëzimi kulturor arkeologjik i saj sepse nuk është kryer ndonjë sondazh i mirëfilltë arkeologjik, por nga materiali i mbledhur arkeologjik, gjatë lëvrimit të tokave bujqësore përreth arealit të saj si dhe nga disa gjetje rasti, mund të konstatohet se kemi të bëjmë me një qendër të evidentuar neolitike që është banuar gjatë kohës së gurit të ri.



■ Fig. 51. Kokë antropomorfe nga argjila e përpunuar dhe e pjekur, zbuluar në Surkish. Gjetje rasti.

■ Fig. 52. Harta e lokalizimit të lokalitetit neolitik të Surkishit. Komuna e Podujevës (Besianë)

Sopata guri të neolitit



■ 53



■ 54

■ Fig. 53/ Fig 54. Koleksion i sëpatave të punuara, të latuara (periudha neolitike) të zbuluara në disa lokalitete të Kosovës. (Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Muzeu i Kosovës)

Datim relativ i periudhës së metaleve



Epoka e ENEOLITIT
3500-2500 p.e.s



Epoka e BRONZIT
2500-1100 p.e.s



Epoka e HEKURIT
1100-mesi i shekullit IV p.e.s

Periudha e metaleve

Periudha e metaleve përfshin një shtrirje të gjatë kohore mbi tremijëvjeçare nga vitet 3500 deri në mesin e shekullit të katërt para erës tonë.

Gjatë kohës së evoluimit gradual të shoqërisë njerëzore, prej përdorimit të gurit kalohet në përdorimin e metaleve të para dhe ky avancim fillon me përdorimin e bakrit që dëshmohet të jetë krijuar dhe shfrytëzuar që në gjysmën e mileniumit të katërt para erës së re.

Në fakt, pasuese e periudhës së re të gurit, respektivisht neolitit, në gjuhën e arkeologjisë njihet si periudha eneolitike (*eneus-bakër* dhe *lithos-gur*), andaj binomi periudha e bakrit apo eneolitit janë e njëjta gjë.

Në kronologjinë historike të territorit të Kosovës, kjo periudhë kohore përfshin kohën nga vitet 3500 deri 2500 p.e.s.

Në vendin tonë janë dëshmuar disa pika arkeologjike të kohës në fjalë dhe nga më të rëndësishmet janë lokaliteti shumësh-tresor i Hisarit në Suharekë (Therandë) dhe lokaliteti shumësh-tresor i vendbanimit të Gadimes së Epërme në komunën e Lipjanit.

Për më tepër, kjo periudhë kohore transitore veçohet për disa ndryshime dhe zhvillime posaçërisht të vërejtura në organizimin e brendshëm të shoqërisë njerëzore nga të cilat lindja e shoqërisë patriarkale dhe fillimi i ndarjes së klasave shoqërore e veçon nga periudhat e mëhershme dhe ato më të vonshme.

Pasuese e periudhës së bakrit ishte periudha e bronzit (2500-1100 p.e.s.). Me avancimin e industrisë manifaktoriale të metalurgjisë parahistorike, dhe me përzierjen e bakrit me kallajin, u krijua bronzi, që luajti rol të madh si në përgatitjen e armëve, ashtu dhe të veglave e stolive.

E veçanta e kësaj kohe qëndron në faktin se tanimë patriarkati e zëvendësoi plotësisht matriarkatin, u zhvillua diferencimii shoqëror dhe dolën në pah elementet e para të aristokracisë fisnore, të gjitha këto ndryshime dhe zhvillime të pasqyruara në kulturën materiale të zbuluar gjithandej.

Në territorin e Kosovës, gjatë viteve janë dëshmuar dhjetëra vendbanime, varreza dhe fortesa të kohës në fjalë, që ndahej në periudhën e bronzit të hershëm, të mesëm dhe të vonë. Megjithatë, kjo periudhë kohore shënon edhe kohën e fillimit të krijimit e të formimit të etnosit ilir që gjatë periudhës pasuese të hekurit (1100-mesi i shekullit të IV p.e.s) përfundon me konsolidimin e plotë të unitetit etnokulturor të ilirëve, gjegjësisht të dardanëve si njëri nga fiset më të populluara dhe me territor të gjerë që Republika e Kosovës zë vend qendror në kuadër të Mbretërisë Dardane.

Përpos shfrytëzimit dhe prodhimit masiv të armëve të hekurit si në luftëra, ashtu dhe të veglave bujqësore e atyre të përdorura për ndërtim, periudha e hekurit në territorin e Kosovës është përfaqësuar si në vendbanime fushore, vendbanimet e fortifikuara me ledhe, hendeqe dhe me mure të thata, por kryesisht karakteristike janë fortesat e vendosura mbi kodra të larta, me pozitë gjeostrategjike e pjesërisht të mbrojtura me mbrojtje natyrore.

‘Vula’ identifikuese e periudhës së hekurit janë varrezat tumulare (kodërvarret Ilire) këto evidentuar, dokumentuar dhe pjesërisht studiuar kryq e tërthor territorit të Republikës së Kosovës, e që janë me qindra, qoftë të vetmuara apo të grupuara.



■ 55




■ 56

Gadime e Epërme

Lokaliteti *Gradishtë* gjendet mbi një sukë në pjesën perëndimore të maleve të pasura me xehe të Zhegovcit. Ka një pozicion të përshtatshëm gjeostrategjik dhe i përket tipit të vendbanimeve kodrinore të eneolitit dhe hekurit. Ky lokalitet ndodhet në pjesën lindore të fshatit të Gadimes së Epërme.

Lokaliteti kishte karakter fortifikues dhe është hulumtuar gjatë viteve 1973-1974, rezultate që dëshmuuan se i takon periudhës së eneolitit (bakrit) përgjithësisht grupit kulturor Bubanj Sallkuca-Krivadoll, por vazhdon të shfrytëzohet edhe gjatë periudhës së vonë të hekurit. Megjithatë, gjatë periudhës së eneolitit ishte rindërtuar disa herë dhe e veçanta e tij është se pikërisht këtu ishte zbuluar një fragment qeramike e zbukuruar me 'teknikën grafito' si dhe e dekoruar me motive të gërvishitura-me mjete të mprehta. Derisa në fazën e më vonshme të hekurit, janë zbuluar fragmente të qeramikës së importuar greke (hele-nistike).




- Fig. 55. Ortofoto e arealit të kodrës së Gradishtës, gjegjësisht e fortësës eneolitike të Gadimes
- Fig. 56. Pamje e lokalitetit-fortësës së Gadimes, e pozicionuar mbi kodrën e Gradishtës
- Fig. 57. Harta e lokalizimit të fortësës eneolitike (epoka e bakrit) të Gradishtës së Gadimes së Epërme, komuna e Lipjanit



Hisar

Lokaliteti arkeologjik, gjegjësisht, vendbanimi prehistorik i Hisarit ndodhet në anën jugperëndimore të Suharekës, e vendosur në një plato (tarracë) që dominon mbi rrafshin në anën veriore dhe e pozicionuar midis Suharekës në veri dhe Shirokës në jug, në krahun e djathtë të rrugës Suharekë–Prizren.

Tarraca ka sipërfaqe të sheshtë eliptike me diametrat 180 x 90 m dhe një sipërfaqe prej rreth 1.1 ha e me lartësi mbidetare prej 422 m. Gërmimet e para në këtë lokalitet janë zhvilluar në disa sezone; 1961-1963, 1978 dhe pas një ndërprerje të disa dekadave, për të vazhduar në vitet 2003-2004. Materiali arkeologjik i zbuluar këtu gjatë gërmimeve i përket periudhës që fillon nga neoliti i vonë deri në periudhën e hekurit dhe në veçanti ka vlera të veçanta për studimin e kulturës materiale të banorëve autoktonë dardanë. Hisari përfaqëson një qendër të rëndësishme të prehistorisë rajonale e ballkanike, ku gjatë epokës eneolitike lulëzoi një qytetërim i vërtetë parahistorik.



- Fig. 58. dhe Fig. 59. Pamje e lokalitetit-fortesës së Hisarit
- Fig. 60. Ortofoto e arealit të kodrës dhe vendbanimit shumëstresor të Hisarit
- Fig. 61. Harta e lokalizimit të lokalitetit shumëstresor të Hisarit



■ 62



■ 63



■ 64



■ 65



■ 66



■ 67

- Fig. 62. & Fig. 63. Dy enë të periudhës eneolitike zbuluar në Hisar (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)
- Fig. 64. Enë kulturi (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)
- Fig. 65. Lugë eneolitike zbuluar në Hisar (3500-2500 p.e.s.) (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)
- Fig. 66. Sëpatë e periudhës së bronzit të hershëm nga Hisari (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)
- Fig. 67. Gurë mokre prehistorike për bluarjen (shtypjen) e drithërave zbuluar në Hisar. Datimi relativ: periudha e hekurit (shek. XI-IX p.e.s.). (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*).



■ 67b

■ Fig. 67b. Stoli dardane. Gjetje rasti në afërsi të vendbanimit të Hisarit- Suharekë. (Therandë) Datimi relativ: shekujt VIII-VII p.e.s. (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)




■ 68

Lokaliteti arkeologjik i Gllarevës gjendet në qendër të fshatit Gllarevë (komuna e Klinës), në krahun e djathtë të rrugës Prishtinë-Pejë, e shtrirë në tokat punuese të Rixhevës. Ky lokalitet është identifikuar rastësisht në vitin 1973.

Gërmimet e zhvilluara arkeologjike në vitet '80 u përqendruan në dy lokacione njëra afër tjetrës, që rezultuan me zbulimin e dy nekropoleve; të varreve me varrosje të lirë dhe të konstruara me pllaka gurësh e me bazë të mbushur me guralecë, si dhe të varreve me djegie.

Gllarevë



- Fig. 68. Pamje e gërmimeve të vitit 1986 në nekropolin e Gllarevës (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 69. Ortofoto e arealit të lokalitetit të Gllarevës, komuna e Klinës
- Fig. 70. Harta e lokalizimit të lokalitetit të Gllarevës
- Fig. 71. Armë, shpata, thika dhe maja heshtash zbuluar në nekropolin e Gllarevës (Muzeu i Kosovës)



Në aspektin kronologjik, ky lokalitet u datua në kohën e fundit të bronzit të mesëm. Në mesin e shumë varreve të humltuara aty, përveç materialit të pasur arkeologjik që ka shërbyer si inventar varri, veçohen disa shpata bronzit tipike mikenase, që më së miri ilustron faktin se shkëmbimet, gjegjësisht kontaktet me qendrat antike greke tashmë ishin konsoliduar.



■ 72



■ 73



■ 74



■ 75



■ 76

■ Fig. 72. Gjilpëra bronzit të mbështjella në formë spiraleje dyshe

■ Fig. 73. Gjilpëra bronzit të farkëtua, të zbuluara në Gllarevë (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 74. Byzylykë për këmbë (varri 1)

■ Fig. 75. Kapëse bronzit të farkëtua dhe të gdhendura (varri 7) të zbuluara në nekropolin e Gllarevës (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 76. Enë të ndryshme nga argjila e pjekur, zbuluar në lokalitetin e periudhës së bronzit të Gllarevës (Muzeu i Kosovës)



■ 77

■ 78

Boka e Përçevës

Nekropoli i tumave të Bokës së Përçevës gjendet pak kilometra në veriperëndim të lokalitetit të Gllarevës. Nekropoli i takon kohës së bronzit të zhvilluar (të vonë) dhe hekurit të hershëm, si dhe është karakteristik për numrin e madh të tumave të vendosur në një kompleks të gjerë. Nëntëmbëdhjetë tuma janë evidentuar këtu nga të cilat shtatë sosh janë hulumtuar gjatë viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar.

Nga materiali i pasur arkeologjik zbuluar këtu, e që përbëhej nga inventarët e varreve tumulare, vërehen objekte të ndryshme si armë, zbukurime dhe enë qeramike të cilësisë së lartë për kohën në fjalë, si dhe këto fakte të pakontestueshme që konfirmojnë gjurmët e një popullsie mjaft të avancuar të etnisë autoktone dardane.




■ 79



■ 80

- Fig. 77. Byzylykë të bronzitë zbuluar në tumat e Bokës së Përçevës (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 78. Koleksion i majave të heshtave zbuluar në nekropolin tumular të Bokës së Përçevës (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 79. Një kopsë e ornamentuar dhe e farkëtuar në bronz, zbuluar në tumën XIV, varri 23, Boka e Përçevës (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 80. Enë e punuar nga argjila e pastruar dhe e pjekur, zbuluar në tumën XIV, varri 7 (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 81. Harta e lokalizimit të lokalitetit të Përçevës






■ 82



■ 83



■ 84



Rogovë

Nekropoli i tumulave të Rogovës gjendet në lokacionin e njohur me emrin *Fusha*, rreth 4 km në juglindje të nekropolit tumular të *Fshejt*, në krahun e djathtë të rrugës Gjakovë-Prizren. Ky kompleks nekropolesh përbëhej prej 6 tumave të ruajtura mirë dhe disa të tjera të dëmtuara.

Për herë të parë është hulumtuar në vitin 1966 dhe më pas në vitet pasuese në 1973, 2005 dhe 2011. Të gjitha këto hulumtime parciale rezultuan se këtu kishte një nekropol me grup tumash që në bazë të analogjisë të materialit arkeologjik zbuluar këtu datohet në kohën e bronzit të mesëm (1800-1500 p.e.s.), por vazhdon të ripër-

- Fig. 82. Pamje e një tume të gërmuar në Rogovë, gjatë vitit 2011 (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)
- Fig. 83. Pamje e një segmenti të një tume të gërmuar në Rogovë, gjatë vitit 2005 (*Muzeu i Kosovës*)
- Fig. 84. Ortofoto e lokalizimit të nekropolit me tumula në Rogovë, në Komunën e Gjakovës.
- Fig. 85. Harta e lokalizimit të nekropolit me tumula në Rogovë, në Komunën e Gjakovës.

doret edhe në periudhën e hekurit të hershëm. Varret tumulare kishin një shumëllojshmëri të pasur inventari që varroseshin së bashku me të ndjerët e që sipas perceptimit të njeriut të asaj kohe, ato ishin objekte personale, qoftë armë, vegla, zbukurime dhe gjësende të tjera materiale të personit apo personave jo të zakonshëm që ishin varrosur aty.



■ 86



■ 87

■ 88



■ 89



■ 90

■ Fig. 86. Dy gjilpëra të njohura si gjilpëra kokëgozhde, tipike për periudhën e bronzit të vonë, zbuluar në një tumë në Rogovë (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 87. Një enë me vegje në trajtë sëpate

■ Fig. 88. Enë dyvegjake e periudhës së bronzit të mesëm zbuluar në Rogovë (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 89. Dy byzylykë të farkëtuar në bronz, zbuluar brenda një varri në tumën 1 në Rogovë (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 90. Varëse qafe nga qelibari, zbuluar në Rogovë (Muzeu i Kosovës)



■ 91

Korishë



■ 92



■ 93



■ 94

Lokaliteti i periudhës së bronzit të Korishës, ishte hulumtuar gjatë vitit 2006 dhe kishte karakter të gjermim-shpëtimimit. Lokaliteti pozicionohet në faqen lindore të qafës në trajtë të shalës, fare pranë kalasë së Korishës. Kemi të bëjmë me një vendbanim me një sipërfaqe prej afër 1 hektar dhe me lartësi mbidetare prej 723-728 metër, të shtrirë në një pjerrësi.

Ky lokalitet kishte karakter të një fortifikimi që mbrohej nga natyra në një anë dhe ledhet mbrojtëse në anët e tjera. Gjermimet arkeologjike të zhvilluara në dy sektorë rezultuan me identifikimin dhe zbulimin e banesave dhe horizonteve të banimit që janë tipike dhe në aspektin kronologjik datohen në periudhën e bronzit të hershëm dhe bronzit të mesëm. Vegla pune të punuara nga guri, fragmente dhe enë qeramike të zbuluara këtu, shumë mirë e përfaqësojnë kohën në fjalë.

- Fig. 91. Pamje nga distanca e lokalitetit arkeologjik të periudhës së bronzit të Korishës (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 92. Pamje e disa kuadrateve të gjermimit në lokalitetin e bronzit të Korishës (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 93. Pamje nga ajri e lokalitetit arkeologjik të Korishës në komunën e Prizrenit
- Fig. 94. Harta e lokalizimit të lokalitetit arkeologjik të Korishës në komunën e Prizrenit



■ 95



■ 96




■ 97

Bërniceë e Poshtme

Lokaliteti i periudhës së bronzit të vonë- hekurit të hershëm të Bërniceës së Poshtme ndodhet rreth pesë kilometra në veri të Prishtinës, e pozicionuar përkrah rrugës Prishtinë-Podujevë (Besianë). Ky lokalitet është kategorizuar në grupin e nekropoleve të dysta ku pas djegies së të ndjerëve, hiri i mbetur vendosej në urna e më pas varrosej në varre individuale apo dhe grupe dhe të rrafshëta, e jo tumulare, e që në literaturën arkeologjike njihen si ‘nekropole të fushave me urna’.

Në bazë të studimit të mënyrës së ngritjes të këtyre varreve, është konstatuar se ato punoheshin, gjegjësisht konstrukttoheshin me përdorimin e gurëve të lëmuar lumorë dhe pllakave dhe rrasave të gurit. Ky lokalitet është hulumtuar në fund të viteve pesëdhjetë dhe sërish gjatë viteve tetëdhjetë, menjëherë me rastin e zbulimit të rastësishëm të një urne. Tanimë, që nga ky zbulim, kjo kulturë është e njohur si Kultura e Bërniceës së Poshtme.



■ Fig. 95. Urnë dyvegjake e Kulturës së Bërniceës (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 96. Urnë dyvegjake e kulturës së Bërniceës (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 97. Urnë dyvegjake e mbuluar me një urnë-kapak, siç ishte zbuluar in situ në një varr në nekropolin e dytë të Bërniceës së Poshtme (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 98. Ortofoto e lokalitetit arkeologjik të Bërniceës së Poshtme

■ Fig. 98a. Harta e lokalizimit të lokalitetit arkeologjik të Bërniceës së Poshtme në komunën e Prishtinës




Ponoshec

Nekropoli tumular i Ponoshecit ndodhet në parcelat e tokave të njohur me toponimin lokal si Arëza, fare pranë përroit Labenicë. Kjo varrezë me tumula, është e grupuar në pesë tuma të evidentuara deri tani dhe shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 5-6 ha. Tumat në përgjithësi kanë përmasa prej 12 deri në 18 m, ndërsa lartësia e tyre e ruajtur shkon deri në një metër.

Gërmimet arkeologjike me karakter shpëtimi të zhvilluara gjatë vitit 2011 rezultuan me një koleksion të larmishëm të gjetjeve të luajtshme dhe të tipareve arkeologjike karakteristike për tumat Ilire.

Rezultatet hodhën dritë mbi kronologjinë dhe kulturën materiale duke përcaktuar shtrirjen kohore që nga periudha e bronzit por me një theks të veçantë intensiteti më i madh i përdorimit dhe ripërdorimit të këtyre kodër varreve ndërlidhet me epokën e hekurit të shekujve XII-X p.e.s. si dhe fundit të kësaj kohe gjatë shekujve VI-IV p.e.s., që njihet dhe si lashtësia dardane.



■ Fig. 99. Amulet me 2 koka gjarpri nga tuma e Ponoshecit. (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 100. Tokëz rripi, varri qendror i tumës I. Periudha e bronzit të vonë (1500-1100 p.e.s.). (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 101. Majë heshte, zbuluar në varrin qendror të tumës 1 të Ponoshecit. Periudha e bronzit të vonë (1500-1100 p.e.s.). (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 102. Pamje e gërmuar e tumës 1 në fshatin Ponoshec në vitin 2011 (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

■ Fig. 103. Harta e lokalizimit të lokalitetit arkeologjik (nekropoli me tumula) të Ponoshecit në komunën e Gjakovës



■ 104

Gjinoc


Tuma e Gjinocit (kodërvarr ilir), është një rast i rrallë në Kosovë i një tume me përmasa gjigante me diametër 84 metra në drejtimin lindje-perëndim dhe 73 metra në orientimin veri-jug.

Tuma ka një lartësi prej gati dhjetë metrash dhe akoma nuk është hulumtuar. Megjithatë, për nga dimensionet, forma e punuar, lartësia dhe vendndodhja e saj, më siguri duhet të datohet nga periudha e zhvilluar e hekurit të lashtësisë dardane dhe me gjasë i përket ndonjë familjeje me ndikim dhe status të lartë shoqëror.

Ky monument mortor gjendet më pak se dyqind metra në krahun e majtë të rrugës Suharekë-Prizren.

■ Fig. 104. Pamje e Tumës së Madhe të Gjinocit në komunën e Suharekës (Therandës)

■ Fig. 105. Harta e lokalizimit të lokalitetit të arkeologjik (Tumës së Madhe) të Gjinocit në komunën e Suharekës (Therandës)



Bellaçec

Fortesa e Bellaçecit (Bardh i Madh) gjendet mbi një kodër të mbrojtur nga konfiguracioni i terrenit natyror nga anët veriore, jugore dhe lindore, ndërsa nga perëndimi mbrohet nga ledhet gjegjësisht hendeqet mbrojtës. Fare pranë, poshtë saj, kalon lumi Drenicë, kurse qindra metra në veri të fortesës ngrihet mali i Çiçavicës.


Kalaja e lashtë ka trajtë trapezoide me sipërfaqe të brendshme 70 x 50 metra, kurse rrethina e jashtme është disa hektarësh dhe karakterizohet prej radhësh ledhesh apo mure të thata të mbushura me gurë dhe dhé. Pozita e shkëlqyeshme strategjike dhe gjeografike e kësaj forte të lashtë, mundëson vëzhgimin e një zone shumë të gjerë drejt horizontit të fshatrave të Fushë-Kosovës. Shtresa kulturore kishte ruajtur për mbi njëzet e tetë shekuj enë qeramike të dekoruara me kanelyra dhe vija të pikëzuara tipike për stilin dardan të kohës së hekurit, këto të njohura në krijimtarinë dhe prodhimtarinë e punimit të qeramikës rajonale dhe lokale.



■ 106



■ 107



Hulumtimet arkeologjike në formë të sondazheve kontrolluese në këtë lokalitet janë zhvilluar në disa etapa; që nga fundi i të gjashtëdhjetave të shek. XX për t'u vazhduar edhe gjatë viteve në vijim.

Një incizim apo surve me aparaturë gjeomagnetike në vitin 2011, ka regjistruar gjurmë të ndryshme të ambienteve të nëndheshme të saj, të cilat presin ditën për të dalë në pah. Ky lokalitet datohet që nga shek. VIII e deri në shek V p.e.s.

- Fig. 106. Enë dyvegjake e periudhës së hekurit (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 107. Ortofoto e kodrës gjegjësisht e fortesës së periudhës së hekurit të këtij lokaliteti me karakter fortifikimi
- Fig. 108. Harta e lokalizimit të lokalitetit arkeologjik të Bellaçecit (Bardh i Madh) në komunën e Fushë-Kosovës

Fshej

Nekropoli tumular i Fshejit i takon periudhës së vonë të hekurit (VII-VI p.e.s.) dhe gjatë hulumtimeve arkeologjike të zhvilluara këtu në vitin 2011 u gërmuan pesë tuma, këto me inventar mjaft të pasur të lëndës arkeologjike dhe përcaktuese të kronologjisë së kohës së konsolidimit të etnisë dardane, gjegjësisht të unitetit etnokulturor të tyre.

Gjendet rreth 800 m në jug-jugperëndim të Urës së Shenjtë. Riti i varrimit (inhumacion) me vendosje të lirë të trupit dhe kjo e kornizuar me gurë lumi, reflekton njërën nga ritet mortore të popullsisë autoktone, krahas asaj me djegie të kufomës (incernacion).



■ 109



■ 110




■ 111



■ 112



■ 113



■ 114

- Fig. 109. Enë dyveqaje e periudhës së bronzit zbuluar në një tumë (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 110. Tuma II, 2011 (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 111. Tuma III, 2011 (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- 112. Varri 1 i tumës II, 2011 (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
- Fig. 113. Ortofoto e këtij nekropoli me tumulat e piketuara (në foto të rrumbullakosur në të kuqe)
- Fig. 114. Harta e lokalizimit të lokalitetit arkeologjik të nekropolit me tumula në fshatin Fshej në Komunën e Gjakovës, gjendet jo larg Urës së Fshejtë




115

Llashticë

Nekropoli i Llashticës gjendet rreth 10 km në verilindje të qytetit të Gjilanit, në krahun e djathtë të Moravës së Binçës, e shtrirë në një sipërfaqe të gjerë të tokave punuese të fshatit Llashticë buzë maleve të Karadakut. Nekropoli përbëhet prej nëntë tumave të evidentuara, karakteristike për periudhën e vonë të hekurit si dhe ndërlidhet me vendbanimin rrafshinor të periudhës së hekurit e cila gjendet rreth 1.5 km në veri të saj, e konstatuar nga sondazhet e zhvilluara në tetor të viti 2011. Hulumtimet arkeologjike në këtë areal janë zhvilluar në disa etapa gjatë viteve 1980, 1981, 1982 (janë hulumtuar gjithsej 5 tuma), si dhe në vitin 2011 është gërmuar tuma VIII, vetëm në dy segmente.

Inventari i varreve (materiali arkeologjik) përbehej prej gjetjeve të shumëllojta si në formë ashtu dhe në material; enë qeramike, vorba, pjata dhe zbukurime (fibula, byzylykë, qafore etj.) si dhe pjesë të fragmentuara të objekteve të kultit me figura të zogjve e të punuara në bronz. Njëra nga tumat (tuma VIII) është në gjendje relativisht të mirë me përmasa të dukshme 32 x 32 m në diametër, ndërsa me lartësi të ruajtur deri në 1.60 metër. Pas gërmimeve u konstatua se në këto varre mungonin mbetjet mortore të të ndjerëve, të cilat me siguri pas dje-gies, hiri iu është shpërndarë. Tumat i përkasin periodizimit të hekurit të vonë.



- Fig. 115. Pamje e një tume të hulumtuar (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 116. Harta e lokalizimit të lokalitetit tumular të Llashticës në komunën e Gjilanit.
- Fig. 117. Ortofoto e shtrirjes së këtij nekropoli me kodërvarre të njohura si tuma ilire



■ 118



■ 119

Shirokë

Varreza me grup të tumave e Shirokës, pozicionohet në fshatin me të njëjtin emër, rreth 1,5 km në jug të Suharekës (Therandës), në krahun e djathtë të rrugës magjistrale. Është nekropol i grupit kulturor Dardan të tipit tumular e ndërtuar me konstruksione të varreve me unaza rrethore e të ngritura prej gurëve të lumenjve dhe të mbuluar me dhe. Në afërsi të nekropolit të Shirokës gjendet lokaliteti shumështrësor i Hisarit si dhe në një afërsi relative shtrihen tumat e Dubiçakut.

Gjurmimet e zhvilluara arkeologjike kanë konstatuar një nekropol të përdorur dhe të ripërdorur gjatë periudhës së bronzit e deri te koha e vonë e hekurit. Materiali i lëvizshëm arkeologjik i zbuluar këtu tregon për një inventar të larmishëm e të veçantë të zbukurimeve e të dekorimeve, si dhe enëve të importuara që mbase indikon shkëmbimet tregtare me botën helene e përtej. Varreza me tumat e Shirokës është ngritur gjatë shek. VIII-VI p.e.s.



■ 120




■ Fig. 118. Stoli (byzylkë krahu) nga Shiroka (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 119. Urnë dyvegjake e zbuluar në një rrenë nga tumat e Shirokës (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 120. Pendant (varëse) të ndryshëm (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 121. Fibulë, zbuluar në tumat e Shirokës (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 122. Harta e lokalizimit të lokalitetit tumular të Shirokës





■ 123



■ 124


Lubozhdë

Fshati Lubozhdë gjendet në perëndim të Istogut, dhe karakterizohet me identifikimin e një lokaliteti arkeologjik të njohur me mikrotoponimin *Livadhi*, që pozicionohet vetëm disa qindra metra në krahun e majtë të rrugës. Aty ndodhen disa tuma që janë tipike ilire të kohës së hekurit, periudhë kjo kur edhe përfundon formësimi etnik dhe kulturor i Ilirëve që banonin tërë gadishullin Ilirik (sot Ballkanik) e përtej.

Zbulimi i një inventari të pasur varri në njërin nga tumat, kryesisht të zbukurimeve të punuara në një cilësi të lartë e të farkëtuar në argjend, si byzylykë që datohen në shekujt VI-V p.e.s., na flet për personalitete të dalluara e të rëndësishëm të varrosura aty.

Vetëm 7 km që këtu, gjendet lokaliteti arkeologjik i Banjës së Pejës, i së njëjtës kohë si dhe materiali arkeologjik shikuar në aspektin analogjik është shumë i përafërt, dhe me siguri që këto dy qendra kanë qenë të lidhura njëra me tjetrën dhe mbase janë të një tërësie të njëjtë.

Incizimet e nëntokës së këtij areali me gjeomagnetikë, gjegjësisht me instrumente gjeofizike të zhvilluara në vitin 2011, identifikuan disa tuma që nuk dallohen nga observimi vizual i këtij terreni të rrafshët.



■ Fig. 123. Byzylykë dore të farkëtuar në argjend dhe të ornamentuar me teknikën e 'rrahjes' (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 124. Byzylyk dore i farkëtuar në argjend me motive të dy koka gjarpërinjsh (Muzeu i Kosovës)


■ Fig. 125. Harta e lokalizimit të lokalitetit të Lubozhdës në komunën e Istogut



Banja e Pejës

Lokaliteti antik arkeologjik i Banjës së Pejës pozicionohet në kryqëzimin e rrugës që lidh Pejën me Istogun, rreth 12 km në veriperëndim të Pejës. Gjatë ndërtimit të një hoteli për kurim shëndetësor (Onix) në vitin 1974, rastësisht janë zbuluar përkrenare ushtarake tipike ilire. Po këtë vit fillojnë gërmimet arkeologjike me karakter shpëtimi që nga materiali i pasur arkeologjik zbuluar këtu e në mesin e shumë gjetjeve janë evidentuar varre për një çift të rëndësishëm dhe nga arkeologët e asaj kohe kjo qendër arkeologjike u njoh si Varri Princëror.

Varri çift kishte bazë të konstruktuar në formë drejtkëndore dhe të pllakosur me gurë shtufi sigurisht të marrë nga zona përreth. Këtu u dallua dhe u dokumentua një varr femëror me inventar të pasur si fibula, gjilpëra në formë omegë, unazë dhe byzylykë të zbukuruar me motive gjeometrike, të gjitha të farkëtuara në argjend dhe bronz. Kurse në varrin tjetër që i përkiste një mashkulli, kishte në përbërje armë, pafta të argjendta dhe të bronzta si dhe një unazë. Dokumentimi arkeologjik i këtyre vlerave shumë të veçanta për terrorin e Kosovës, ndër të tjera flet dhe për diferencimin social dhe ekonomik të individëve apo grupeve të shtresave elitare të kohës në fjalë. Materiali i pasur arkeologjik determinon kohën e periudhës së vonë të hekurit, shekujt VI-V p.e.s.



■ Fig. 126. Helmetë apo përkrenare ushtarake tipike ilire e shekujve VI-V p.e.s., pamje ballore dhe anësore (Muzeu i Kosovës)

■ Fig. 127. Harta e lokalizimit të lokalitetit të Banjës së Pejës në komunën e Istogut (Burimit)

I tërë mikrorajoni përreth këtij lokaliteti ka gjurmë të ndryshme të kulturës materiale arkeologjike të periudhave të ndryshme kohore, që reflekton vazhdimësinë e jetës pa ndërprerje. Me siguri që ky lokalitet ishte atraktiv falë burimeve termale (kuruese) që gjenden këtu, por në anën tjetër, peizazhi dhe pozita e volitshme gjeostrategjike kanë luajtur një rol në përzgjedhjen e kësaj vendndodhjeje arkeologjike.



■ 128



■ 129



■ 130



■ 131



■ 132

- Fig. 128. Dy Byzylykë dore të farkëtuar në argjend nga varri i Banjës së Pejës (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 129. Unazë argjendi e farkëtuar (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 130. Unazë argjendi e stilizuar me motiv të spirales dyshe paralele (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 131. Rruaza të punuar nga qelibari (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 132. Kopsa të farkëtua në bronz, zbuluar në varrin e Banjës së Pejës



■ 133

Prizren, gjetje të veçanta rasti

Një gjetje rasti e një eksponati shumë të veçantë zbuluar diku në Prizren gjatë pjesës së dytë të shekullit XIX kishte të bënte me një statuetë të hedhur në bronz e që paraqet figurën e një vajze-atleteje në vrapim. Përndryshe njihet dhe si Menada e Prizrenit. Statueta e bronzit ka një lartësi prej 11.4 cm dhe mund të ketë qenë pjesë zbukuruese e fiksuar e ndonjë ene të veçantë dekorative. Statueta mendohet se është punuar gjatë periudhës kohore arkaike dhe datohet diku rreth viteve 520-500 p.e.s. Ky eksponat i vetëm i llojit të vet zbuluar ndonjëherë në Kosovë, gjendet e ekspozuar në Muzeun Britanik të Londrës që nga viti 1876; pasi që ishte blerë nga një tregtar antikuaresh, i njohur vetëm me emrin Serafim dhe që mendohet se ishte me origjinë armene. Megjithatë, artefakti në fjalë është pjesë e koleksionit të muzeut në fjalë, gjegjësisht gjendet në fondin e saj të Departamentit të Antikitit Grek dhe Romak. Figurina e bronzit është në 'lëvizje' gjegjësisht në vrapim, me trupin e kthyer përpara derisa shikimin e ka poshtë në të djathtë të saj dhe duke mbajtur fundin me dorë të majtë. Në fakt ajo ka të veshur një hiton të shkurtër që ngjason në një fund me një krahoshë deri sa gjiri i djathtë i saj është i zbuluar, kurse flokët i bien paralel e të valëzuara nga prapa. Vrapuesja apo Menada e Prizrenit është një artefakt i importuar me siguri nga Sparta greke.

Një gjetje tjetër dhe e rrallë si dhe po aq e veçantë sa vrapuesja e Prizrenit është figurina e bronzit e cjapit të ulur që i takon shek. VI p.e.s. Sipas të dhënave të shkruara, kjo figurinë është zbuluar rastësisht në vitin 1939, diku në Jaglenicë, lagje periferike e Prizrenit. Kjo figurinë ka gjatësi prej 6,5 cm, gjerësi rreth 3 cm dhe lartësia e saj shkon 6,5 cm. Pesha e saj është vetëm 380 gram. Figurina e cjapit të ulur sot gjendet e ekspozuar në Muzeun e Vranjes. (Muzeu i Vranjes)



■ Fig. 133. Vrapuesja apo Menada e Prizrenit, nga para dhe prapa (Muzeu Britanik)

■ Fig. 134. Cjapi i bronzit, i ulur, foto para dhe prapa (Muzeu i Vranjes)




■ 135

Kamenicë, gjetje unike rasti

Një relief i skalitur apo stelë e shfaqjes së një procesioni mortor që pasqyron kortezhin funeral të një burri, arkivoli i të cilit përcillet nga ajo që duket të jetë e shoqja e të ndjerit në krye të saj, ishte gjetur rastësisht në arealin e kalasë së Kamenicës (Dardanës) gjegjësisht rrëzë saj në jugperëndim të këmbët e kalasë. Është krijimtari e kohës së fundit të periudhës klasike (V-IV p.e.s), por mund të jetë edhe nga fillimi i periudhës helenistike (IV-I p.e.s.). Kjo skenë i përngjan gjamës apo vajtimit masiv që është një rit i organizuar, këndim vajtues në grupe, që praktikohet ende në Malësinë e Gjakovës, dhe si e tillë mbase mund të trajtohet si trashëgimi shpirtërore mijërvjeçare. Në anën tjetër, nëse shikohen figurat e grave në këtë monument që paraqet një ceremoni funebër, vajtueset mbajnë të veshur një lloj fustani që ngjason me xhubletën ilire (në formë kambanore), dhe e cila mendohet se ishte një veshje tipike autoktone, e grave e përdorur që nga periudha e bronzit dhe që akoma praktikohet në viset e thella malore dhe në vendet e ngritura në trojet e banuara me shqiptarë. Stela relievore (e fragmentuar) gjendet e ekspozuar në lapidariumin

e Parkut Arkeologjik të Muzeut të Kosovës, ndërsa një xhubletë tipike e kohës së re gjendet e ekspozuar në Muzeun Etnografik “Emin Gjiku” në Prishtinë.



■ Fig.135. Stela e Kamenicës

■ Fig.136. Vëndgjetja e stelës të kalaja e Kamenicës.

Periudha Romake

Periudha romake përfshin periudhën kohore të katër shekujve të parë të mileniumit të parë të erës sonë. Në shekullin I e.s. pas pushtimit të plotë të Ilirisë, romakët vendosën sistemin e tyre administrativo-ushtarak edhe në Dardani, ku ata shtrin marrëdhëniet skllavopronare në prodhim, gjë e cila preku masa të mëdha të popullsisë vendase. Me këtë filloi procesi i shkallëzuar apo gradual i romanizimit të saj që në fakt ishte i pjesshëm dhe nuk ndryshoi trungun etnik të popullsisë autoktone dardane.

Me zbatimin e politikës agrare u krijuan “*ager provincialis*” dhe “*ager publicus*”, prona të shtetit romak, megjithatë një pjesë e pushtetit dhe administrimit lokal ngeli në duar të vendorëve gjithnjë duke u respektuar pushteti qendror. Shteti romak kishte përpunuar një sistem të mbledhjes së taksave dhe të detyrimeve të tjera në popullsitë e viseve të pushtuara, nga të cilat taksat kryesore kanë qenë ato që paguheshin për tokën dhe për frymë (tributum soli dhe tributum capiti). Gjatë dy shekujve të parë të administrimit të Dardanisë, romakët ndoqën një politikë shtypjeje ndaj popullsisë vendase duke i shfrytëzuar si fuqi punëtore, si minatorë në minierat e pasura me xehe por edhe si bujq skllavë në punimin e tokës, pasi që kolonët e ardhur përfituan fonde të mëdha të tokave punuese.

Megjithatë, paqja romake (*Pax Romana*) e vendosur gjatë sundimit të Augustit, krijoi kushte për prosperitetin ekonomik dhe përhapjen e civilizimit romak nëpër provinca. Me rënien e Dardanisë nën pushtimin dhe administrimin romak, ky territor bëhet pjesë e provincës të Mezisë (*Moesia*), e cila ngjan të ketë ndodhur ndërmjet viteve 2 dhe 6 e.s., kurse pas vitit 86 e.s. në kohën e sundimit të perandorit Domician (81-96), Dardania bëhet pjesë e provincës së re të Mezisë së Epërme (*Moesia Superior*). Sidoqoftë, viti 297 ishte historik për dardanët dhe Dardaninë, sepse me këtë vit shënohet edhe data e mëvetësimit të Provincës së Dardanisë, por në kuadër të Perandorisë

Romake. Romanizimi i Dardanisë, përkundër ekzistimit të qendrave urbane (*Scupi, Ulpiana, Naissusi, Municipium Dardanorum* etj) ishte i vonshëm, tejet i përciptë dhe i sipërfaqshëm, gjë që shihet edhe nga ekzistenca dhe funksionimi i mëtejshëm i shumë “*Castella*” (kështjellave) dhe “*Opida*” (qytezave).

Që nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, udhëpërshkrues të ndryshëm të huaj si Ami Boue, Gilferding, Hahn, Mackenzie, Irby, Domashevski, Premestein, Jastrebov, Vulic, Truhelka, Boskovic, Kanitz, Tomascek, Jirecek, Patsch, Saria etj, u shfaqën ndër këto vise apo u morën me lashtësinë e kohës romake që ishte evidentuar në territorin e Kosovës.

Vlen të veçohet studiuesi anglez, Sër Artur John Evans, i cili gjatë hulumtimeve të tij në Ballkanin Qendror (1875) na ofron disa të dhëna të çmueshme edhe për hapësirën e Kosovës. Ai është i pari autor që evidentoi ekzistencën e Municipium DD (Dardanorum) pozicionuar afër Mitrovicës si dhe na ofroi disa të dhëna relevante për disa gjetje apo qendra arkeologjike si në Banjicë të Istogut, Runjevë, Kaçanik, Han të Elezit, Gushtericë e Ulët etj.

Pa dyshim që sundimi romak solli një ndryshim të madh në trevat e banuara nga dardanët, që dëshmohej sidomos në urbanizimin e tyre, evidente edhe në marrëdhëniet shoqërore, kulturore, ekonomike e religjioze të romakëve dhe dardanëve, që më së miri këtë e ka dokumentuar pionieri i arkeologjisë romake dhe punëtori i palodhur shkencor i Muzeut të Kosovës, tashmë i ndjeri Dr. Emil Çershkov.



■ 137



■ 138



■ 139



■ 140

■ Fig. 137. (avers dhe revers) Monedhë e zbuluar në Ulpianë; shek I, perandori Vespasian (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)

■ Fig. 138. (avers dhe revers) Medaljon i zbuluar në Ulpianë; shek III, perandori Probi (*Muzeu i Kosovës*)

■ Fig. 139. (avers dhe revers) Monedhë e zbuluar në Ulpianë; fillimi i shekullit IV, perandori Maksimian (*Instituti Arkeologjik i Kosovës*)

■ Fig. 140. (avers dhe revers) Solidus- monedhë e artë, vendgjethja e panjohur; shek VI, perandori Justiniani i Madh (*Muzeu i Kosovës*)



■ Fig. 141. Fragment terrasilate nga Ulpiana



■ 142



■ 143

Municipium D.D. ('Dardanorum')

Lokaliteti arkeologjik Municipium DD (Dardanorum), ndodhet në pjesën veriore të Kosovës, rreth 27 kilometra në veri të Mitrovicës, në komunën e Leposaviqit, e lokalizuar në fshatin Soçanicë dhe me një pozitë të shkëlqyeshme gjeografike, e pozicionuar në mes të grykëderdhjes së lumenjve Ibër dhe Soçanicë në një anë dhe në mes të bjeshkëve të Rogoznës dhe Kopaonikut, në anën tjetër. Zona përreth ishte e pasur me xehe metalike si arë dhe argjend, dhe pikërisht për këto burime natyrore u ngrit nga një vendbanim i vogël, në njërin ndër qendrat më të rëndësishme urbane antike mjaft aktive gjatë periudhës së sundimit të romakëve ndër këto troje.

Në burimet e shkruara si dhe në literaturën antike apo edhe në itineraret romake, nuk ka as edhe një fjalë për ekzistencën e tij, megjithatë, ekzistenca e këtij vendbanimi u dëshmuar vetëm me rastin e hulumtimeve sistematike të zhvilluara gjatë pjesës së dytë të viteve pesëdhjetë dhe gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar. Gërmimet e ndërmarra u përqendruan në pjesën lindore të vendbanimit, ku edhe janë zbuluar forumi, horrea, bazilika urbana, pjesë të termave dhe detaje të disa objekteve shoqëruese si dhe nekropoli verior.

Nga gjetjet e materialit arkeologjik rezultojnë se Municipium DD ka ekzistuar fillimisht si vendbanim parahistorik për t'u rritur dhe zhvilluar në një qytet të mirëfilltë antik romak në periudhën kohore prej pjesës së fundit të shekullit të parë e deri në pjesën e parë të shekullit të katërt të erës sonë. Ky vendbanim ka karakteristikat e një qyteti tipik të urbanizuar romak dhe kap hapësirën prej rreth 30 hektarësh.



- Fig. 142. Pamje e Municipium DD
- Fig. 143. Fibulë e zbuluar në Municipium DD
- Fig. 144. Foto satelitore e Municipium DD
- Fig. 144a. Vendndodhja e Municipium DD



■ 145



■ 146


Vindenis

Në mesin e tri stacioneve rrugore që kanë qenë ngritur në Dardaninë e kohës romake, ishte edhe Statio Vindenis, lokalitet arkeologjik i identifikuar në fshatin Gllamnik, në komunën e Podujevës (Besianë), rreth 5 km në jug-juglindje të kryeqendrës së kësaj komune. Rruga antike Via Lissus-Naissus (Lezhë-Nish) ishte një rrugë diagonale, që e lidhte pjesën qendrore të Ballkanit me detin Adriatik dhe kalonte përmes Vindenisit.

Vendbanimi dhe stacioni romak i Vindenisit shtrihet në prapatokën e bregut të djathtë të lumit Llap dhe kap një sipërfaqe prej të paktën 15-20 hektarësh. Gërmimet arkeologjike sistematike gjashtëvjeçare të zhvilluara gjatë viteve tetëdhjeta të shekullit që lamë pas, hapën një sipërfaqe totale prej rreth 550 m². Gjetje karakteristike janë varrimi birituale si me djegie, ashtu dhe me varrim trupash. Por këtu u zbulua një sarkofag disa tonësh i mermertë, me siguri për ndonjë person me status të lartë ekonomik e politik. Gjurmimet identifikuan disa ambiente banimi, por në veçanti dallohej një mozaik dyshemeje i dekoruar me motive gjeometrike, në pjesën qendrore të së cilës gjendej shfaqja figurale e Orfeut.

Një gjetje e veçantë e zbuluar në këtë lokalitet është një unazë martesore (fig.149) e arit me kameo (*cameo*) ku qartë dallohet paraqitja e shtrëngimit të duarve të djathta (*dextrarum iunctio*) dhe nënkupton një marrëveshje por edhe simbolizon besnikërinë dhe miqësinë.

Incizimet apo prospektimet gjeofizike e gjeomagnetike të ndërmarra këtu në vitin 2008 dhe 2011, survejuan rreth 11 hektarë sipërfaqe të këtij areali shumë të rëndësishëm arkeologjik dhe identifikuan gjurmë të ndryshme të objekteve që ngjasojnë shumë në një fortesë fushore ushtarake, që edhe do të duhej të ishte e stacionuar aty, kjo për faktin e rëndësisë së mbrojtjes së këtij stacioni rrugor dhe në tërësi zona mjaft e rëndësishme përreth. Vindenis ka qenë aktiv gjatë gjithë periudhës romake dhe antikës së vonë.



■ 147

■ 148



■ 149

- Fig. 145. Mozaiku i Orfeut nga Vindenisi (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 146. Sarkofagu i mermertë nga Vindenisi (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 147. Vendndodhja e Vindenisit (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 148. Vorrë qelqi
- Fig. 149. Unazë e artë zbuluar në Vindenis (Muzeu i Kosovës)




Pestovë

Fshati Pestovë gjendet në komunën e Vushtrisë dhe shtrihet buzë magjistrales Prishtinë - Mitrovicë, në anën e majtë të kësaj rruge, rreth 4 km pa arrihur në qytezën e Vushtrisë, në një zonë mjaft të begatshme bujqësore.

Me rastin e hapjes së kanalit për infrastrukturën nëntokësore në këtë fshat, në vitin 2005, u ndërmor një gërmimshpëtimi dhe me ç'rast u zbuluan pjesërisht themelet e një Villae Rusticae, që ishin shtëpi tipike banimi të kohës romake të vendosura në fshatra larg qendrave urbane. Zakonisht ato ishin njëkatëshe, me atrium apo oborr qendror.



Vilat, sipas arkitekturës antike romake, kishin një strukturë komplekse ndërtimi duke u përbërë nga disa ambiente shoqëruese si banjë apo termæ dhe nga depozita të ujit të pijshëm. Vila rustica e Pestovës ishte një vilë me korridor. Vila në kulturën romake nënkupton një shtëpi luksoze, në qytet (villae urbana), kurse në fshat (villae rusticae) ku shërbente si vendpushim apo vend relaksimi i familjeve të pushtetshme dhe të pasura romake. Vila përbëhej nga shtëpia e padronit (në rastin tonë vila duhet të ketë qenë pronë e një familjeje latifondiste, mbase e familjarëve të pasur Furi apo Ponti të Ulpianës antike). Vila zakonisht shoqërohej nga stalla e kafshëve shtëpiake, punësoria dhe depoja apo magazina për strehimin e të korrurave. Duke u mbështetur në hartën antike Tabvla Imperii Romani, mendohet se fare pranë mund të ketë kaluar traseja e rrugës që lidhte Ulpianën me qytetin antik të Municipum DD.



- Fig. 150. Pamje nga lart
- Fig. 151. Pamje e ambientit qendror të vilës
- Fig. 152. Pamje e hyrjes qendrore në Villae Rusticae të Pestovës
- Fig. 153. Vendndodhja e Pestovës



Poslishtë

Me rastin e ndërtimit të segmentit rrugor të autostradës Prizren-Vërmicë, gjatë vitit 2010, rreth një kilometër në jug të lokalitetit shumë shtresor të Vlashnjes, në anën e majtë të rrugës Prizren-Vërmicë, gjegjësisht 150 m në të hyrë të rrugës që të shpie në fshatin Poslishtë; u ndërmorën gërmime me karakter shpëtimi të një lokaliteti të paid-entifikuar të kohës romake, por që dihej edhe më parë se ekzistonte; nga gjurmët që janë hasur mbi sipërfaqe të një materiali arkeologjik të datuar në periudhën romake.

Gërmimet rezultuan me zbulimin e një Statio (stacion rrugor) që gjendej i lokalizuar përgjatë rrugës së njohur Via Lissus-Naissus. Përpos materialit të ndryshëm të luajtshtëm arkeologjik, në kuadër të kësaj tërësie arkeologjike, u identifikua një Mansio (bujtinë rrugore) me disa anekse, e ku spikatej një Thermae (banjo tipike romake). Me siguri pjesë të kësaj bujtine duhet të kenë qenë edhe Mutatio apo stacione për këmbimin e kuajve të lodhur me të freskët, shërbime këto që ofroheshin pothuajse në çdo stacion rrugor përgjatë 'autostradave' romake gjatë gjithë periudhës romake.



- Fig. 154. Pamje e banjos romake zbuluar në Poslishtë
- Fig. 155. Pamje e një ambienti të stacionit rrugor, e tipit mansio (bujtinë)
- Fig. 156. Vëndndodhja e stacionit rrugor romak në fshatin Poslishtë



■ 157



■ 158


Staradran

Fshati Staradran gjendet në jug-jugperëndim të Istogut. Në lagjen Mavraj të fshatit në fjalë, në kullën e Etem Beqë Mavrajt, mu sipër hyrjes së saj, gjenden të murosura dy fragmente të monumenteve epigrafike. Këto dy mbishkrime të skalitura në pllaka të mermerit, e të murosura në harkun (qemerin) e portës së kullës në fjalë, njëra nga to (fig.157) është një fragment i pllakës prej mermeri me përmasa 17 x 23,5 cm, lartësia e germave 4 cm, dhe ka të gdhendur emrin e hyut Merkur, por edhe emrin e dedikuesit Ulp(ius) Viat(or). Merkuri në mitologjinë romake personifikohej me rolin e pajtorit të tregtisë dhe të lajmëtarit të perëndive, dhe si kult i tillë ka qenë prezent pothuajse në tërë territorin e Dardanisë antike.

Në fragmentin e dytë (fig.158), po ashtu pjesë e një pllake nga mermeri i bardhë me përmasa 23 x 15 cm, vërehet ndarja e germave me gjethe urthi. Të dy këto fragmente janë pjesë të ndonjë altari dhe i përkasin periudhës romake (shek. II-III).

Sipas të dhënave gojore, të dy këto fragmente janë marrë nga fshati Banjicë e Istogut për ndërtimin- zbukurimin e kullës në fjalë, e cila është ndërtuar në mes të viteve 1905-1907.

- Fig. 157. Fragment i pllakës së mermertë me mbishkrimin e Merkurit.
- Fig.158. Fragment mermeri i periudhës romake ripërdorur në njërin nga muret e kullës
- Fig. 159. Vëndndodhja e fshatit Staradran, gjegjësisht lokalizimi i kullës ku gjenden të murosura spoliet e periudhës romake





■ 160




■ 161

Cërcë

Në fshatin Cërcë, rrëzë maleve të Moknës, jo më larg se 2 km në perëndim të qytezës së Istogut, gjatë lëvrimit të tokave punuese, në lokalitetin *Arat e Njoma*, rastësisht u zbulua një artefakt i veçantë, një pllakë-tullë (*Laterculi*) nga argjila. Mbishkrimi në fjalë ilustron faktin se diku aty afër, në kohën romake ishte ngritur një termë (banjo romake) që siç duket ishte emërtuar *Labanon*. Areali i identifikuar arkeologjik këtu është një fushë, tokë punuese me sipërfaqe prej 4-5 ha, e pozicionuar rreth 1 km larg restorantit të peshkut “Trofta”.

Po në këtë areal, një lokacion njihet me mikrotoponimin Kisha e Vjetër, sipërfaqe kjo rreth 200 metra katrorë, ku në pjesën qendrore gjendet një bregore e ngritur rreth gjysmë metri e lartë, indikative për gjurmët e ndonjë monumenti që gjendet në nëntokë. Material arkeologjik si fragmente të tjegullave, tulla, gurë të themeleve të lidhura me horasan si dhe fragmente të qeramikës, të gjitha këto të periudhës së antikitetit të vonë.

Vendasit flasin edhe për një kishë të vjetër ilire që mund të jetë e kohës së krishterimit të hershëm por akoma e pakonfirmuar.



■ Fig. 160. Pamje e lokalitetit arkeologjik

■ Fig. 161. Laterkuli i Cërcës

■ Fig. 162. Vendndodhja e lokalitetit arkeologjik në fshatin Cërcë të Istogut




■ 163

Kllokot-Vërban

Gjurmet e lokalitetit të evidentuara të Vërbanit, pozicionuar fare pranë Banjës së Kllokotit, e të ngritur mbi një tarracë aluviale përgjatë brigjeve të lumit Moravë, në një areal me tokë shumë pjellore dhe në afërsi të vendburimeve të ujërave termale e të ngrohta minerale nuk ishte e rastit.

Njëra nga gjetjet më të rëndësishme të këtij areali shumë të gjerë këtu ishte me rastin e zbulimit të një busti fare pranë Banjës së Kllokotit, vepër arti dardan që përfaqëson një shembull të punimit të skulpturës në mënyrë autoktone, e dallueshme si në formë, ashtu dhe në aspektin artistik dhe që reflekton zhvillimin e krijimtarisë së lartë artistike të popullsisë vendase.

Busti është i punuar në mermer kualitativ dhe reflekton figurën dinjitoze të një zonje Dardane.



■ Fig. 163. Busti i mermertë i një zonje dardane

■ Fig. 164. Vendndodhja e vendbanimit romak të Vërbanit



■ 165




■ 166

Paldenicë

Rreth 150 m në anën e majtë të magjistrales Prishtinë-Shkup, në hyrje të fshatit Paldenicë, mbi një kodër që shtrihet nga perëndim, e me konfiguracion terreni në formë të shalës së kalit, e që ka pamje të gjerë të grykës së Lepencit dhe hyrjes së Hanit të Elezit, janë evidentuar gjurmë të shumta qeramike romake, si dhe material ndërtimor.

Në vitin 1967, në arealin që gjendet në prapashpinën e bregut të majtë të lumit Lepenc, disa qindra metra përgjatë rrjedhës së lumit në drejtim të Hanit të Elezit, e në afërsi të rrugës magjistrale Prishtinë-Shkup, u identifikua një nekropol si dhe u mbledh një sasi e konsiderueshme e materialit arkeologjik, nga të cilat gjetje spikatin disa fragmente të kandilave të periudhës romake si dhe në veçanti pjesë të rripave-brezoreve, këto të derdhura në bronz si dhe të zbukuruara nga masa të qelqit dhe millefiori (teknikë e veçantë e punimit në qelq).

Në bazë të gjetjeve, nekropoli i përket periudhës romake të shekujve II-III. Këtu edhe në vitin 1995, gjatë punimit të tokave rastësisht u zbulua një stelë mermeri me këto përmasa: 160 X 97 X 17,5 cm. Stela datohet nga fundi i shek. II apo fillimi i shekullit III. Po në këtë lokalitet, janë zbuluar edhe dy bazamente për kolona. Lokaliteti në fjalë mund të lidhet me një vendbanim të periudhës romake dhe duke shikuar r konfiguracionin përreth, mund të supozohet se mbase këtu mund të gjenden gjurmë të një stacioni rrugor romak nga kalonte rruga antike Scupi-Ulpiana.



■ Fig. 165. Rrip-brezore, e zbukuruar në teknikën millefiori, zbuluar në Paldenicë

■ Fig. 166. Stelë romake zbuluar në Paldenicë

■ Fig. 167. Vendndodhja e lokalitetit të Paldenicës (Paldenikut)

Municipium Ulpiana

Lokaliteti antik romak dhe bizantin i Ulpianës është pa mëdyshe njëra nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjerë të Gadishullit Ilirik. Shtrirja pranë depozitimeve minerare/xehetare të pasura me metale të çmueshme, pozicionimi me toka pjellore dhe peizazh piktoresk përreth saj, si dhe pozita kyçe gjeostrategjike në një udhëkryq rrugësh antike që lidhte lindjen me perëndimin, ishin faktorë përcaktues për themelimin, zhvillimin dhe ekzistencën e saj shekulllore.

Gjatë periudhës romake, Ulpiana ishte njëra nga qendrat kryesore gravituese komunikuese në mes të Konstantinopolit dhe Romës dhe pikërisht shumë pranë qytetit antik bëhej kryqëzimi i rrugëve që lidhte detin Adriatik me detin Egje dhe indirekt edhe me Detin e Zi. Për më tepër, është e njohur nyja komunikuese Via Lissus-Naissus dhe ajo e Scupit, rrjete këto komunikuese tokësore që takoheshin mu pranë Ulpianës.

Jeta dhe gjurmët e para të civilizimit në Ulpianë janë dëshmuar që nga periudhat e hershme parahistorike, por duhet vënë theksin posaçërisht në periudhën e njohur me zhargonin e arkeologëve si periudha e bronzit dhe ajo e hekurit, apo e njohur ndryshe si lashtësia dardane.



■ 168



■ 169




■ 170



■ 171

- Fig. 168. Altar me mbishkrim grek nga Apolon Menelau kushtuar Zeusit (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 169. Koka e mermertë e aktorit (Muzeu i Kosovës)
- Fig. 170. Kandil nga periudha romake (IMMK)
- Fig. 171. Hyu i Merkurit, punuar në bronz dhe zbuluar në Ulpianë (MK)
- Fig. 172. Vendndodhja e Ulpianës





■ 173

Megjithatë, formën e një qendre të urbanizuar Ulpiana e arrin disa dekada pas pushtimit të Mbretërisë Dardane nga romakët, gjegjësisht në fund të shekullit të parë të erës sonë dhe zhvillohet nga një vendbanim i lashtë dardan apo opidum i koncentruar, në një vendbanim të gjerë dhe të hapur e mjaft të organizuar, ku shfaqen atributet e një qyteti tipik romak.

Në lidhje me themelimin e kësaj qendre arkeologjike mendohet se në vitin 169 e.s. Ulpiana e fiton statusin e municipit (Municipium Ulpianum). Sidoqoftë, Ulpiana zhvillimin më të madh e ka arritur në periudhën në mes të shekujve III dhe IV të e.s. periudhë kjo kur shndërrohet në një qendër të fortë politike, ekonomike dhe kulturore të një territori të gjerë në brendësi të Dardanisë duke u bërë pika kyçe e përhapjes së civilizimit antik. Qyteti në fjalë gjatë kësaj periudhe kohore gëzonte epitetin Municipum Ulpiana Splendissima - municipi i Ulpianës madhështore apo të shkëlqyeshme, duke u karakterizuar me rrjete të rrugëve të drejta, sistem ortogonal, ujësjellës, objekte të banimit si dhe me objekte publike, sakrale, profane e utilitare, gjithnjë duke qenë qendër urbane me rëndësi metalurgjike, zejtare, tregtare e bujqësore gjatë 5 shekujve të parë të mileniumit të parë, e posaçërisht gjatë sundimit të perandorit Justinian në shekullin VI, kohë kjo kur riemërohet në Justiniana Secunda.

Sa u përket hulumtimeve arkeologjike, që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar e këtej, qyteti antik i Ulpianës ka qenë në vazhdimësi areal studimi nën llupën dhe kazmën e arkeologëve vendorë, por edhe të huaj, dhe deri më tani janë zbuluar disa monumente kulti dhe objekte sakrale, pjesë të mureve rrethuese së bashku me kullat mbrojtëse, castrum apo garnizoni ushtarak romak, pastaj qindra fragmente

të gjetjeve/artefakteve të llojllojshme si në formë, material e destinim, por edhe mbetje njerëzore, struktura dhe elemente arkitekturale, të gjitha këto dëshmi të kulturës materiale shumë të rëndësishme për fushën e arkeologjisë, të cilat pjesërisht janë studiuar, por që do të studiohen sistematikisht edhe në të ardhmen edhe nga specialistë të disiplinave të ndryshme shkencore që i kontribuojnë shkencës së madhe të arkeologjisë.

Meqenëse shekulli ynë është shekulli i inovacioneve teknike dhe shkencore, Ulpiana iu është nënshtruar studimeve të elaboruara me mjete shumë të sofistikuara hulumtuese që në thelb janë jointrusive ose metoda pa ndërhyrje fizike, kjo falë një bashkëpunimi në mes të Institutit Arkeologjik Gjerman dhe Institutit Arkeologjik i Kosovës në anën tjetër. Incizimet gjeofizike janë kryer me metodën e Fluxgate Magnetometer, gradiometër, gjeoradar e të ndërlidhura me GIS, duke incizuar mbi 50 hektarë tokë me potencial arkeologjik të arealit të Ulpianës.

Përveç karakterit shkencor, këto incizime nëntokësore do të ndihmojnë edhe në planifikimin e projekteve të ardhshme arkeologjike, e sidomos për krijimin e kushteve dhe përpilimin e planeve zhvillimore për promovimin e turizmit kulturor apo të njohur në botë si arkeoturizëm, që si parakusht ka ngritjen e sistemit të infrastrukturës turistike në parqet arkeologjike. Në anën tjetër, këto kërkime do të ndihmojnë edhe në identifikimin e shtrirjes, përcaktimin e karakterit dhe natyrës shumështrësore arkeologjike të Ulpianës.

■ Fig. 173. Shtrirja dhe vendndodhjet e hulumtuara arkeologjike të monumenteve zbuluar në Ulpianë.

■ Fig. 174. Ortofoto e Ulpianës

■ Fig. 175. Pamje e narteksit të bazilikës së Ulpianës

■ Fig. 176. Pamje e apsidës së bazilikës së Ulpianës

■ Fig. 177. Pamje e kuadrateve të gërmuara në Ulpianë në vitin 2011






■ 178

Uglar-*Statio Viciano*

Fshati Uglar gjendet në pjesën veriore-veriperëndimore të komunës së re të Graçanicës. Mendohet se pikërisht në arealin e këtij fshati mund të gjenden rrënojat e stacionit antik rrugor Viciano, ku ndalonin karvanet që lëviznin nëpër një rrëzë ndër rrugët kryesore transilirike Via Lissus-Naissus, e që nisej nga brigjet e Adriatikut, nga Lezha dhe duke përcjellë luginën e Drinit të Bardhë komunikonte në diagonale nëpër Dardaninë e lashtë (Kosova e sotme) për të vazhduar drejt Nishit.

Stacioni rrugor në fjalë, Viciano ishte regjistruar në një hartë të njohur me emërtimin Tabula Peutingeriana, e cila ishte një kopje mesjetare e shekullit XV e një harte të kohës romake të shek. III-të itinerareve rrugore romake. Afërsia e saj me qendrën Municipium Ulpiana, e lidhte rrugën me këtë qytet antik të njohur posaçërisht për minierat e pasura me xehe të çmueshme, mall ky jashtëzakonisht i vlefshëm për mirëqenien e Perandorisë Romake gjatë katër shekujve të parë të milenumit të parë të erës sonë



■ Fig. 178. Tabula Peutingeriana

■ Fig. 179. Vëndndodhja e lokalitetit të Uglarit, ku supozohet të ketë qenë stacioni rrugor Viciano



■ 180




■ 181

Nerodime e Poshtme

Në vitin 1988, në fshatin Nerodime e Poshtme, e pozicionuar në perëndim të qytetit të Ferizajt, disa sondazhe arkeologjike të zhvilluara këtu në arealin fare pranë varreve ortodokse, rezultuan me zbulimin e një kompleksi prej një vile të antikës së vonë, me atrium dhe mozaik polikromi, gjeometrik dhe figural i dyshemesë. Faza e parë i përket shek. IV, kurse rindërtimi dhe mbindërtimi i takon shek. V-VI. Mozaiku u zbulua në dyshemenë e një dhome drejtkëndore me absidë, mbase që ka shërbyer si triklinijum.

Duke u mbështetur në kompozimin e mozaikut të dyshemesë zbuluar në këtë lokalitet dhe analogjia e stilit të kompozimit të mozaikut me martirijumin e Heraclea Lyncestis në Maqedoni si dhe martiriumin e bazilikës së Linit në Shqipëri, ngjajshmëria e të dy lokaliteteve (mozaiqeve) të lartëpërmenduar me mozaikun e Nerodimes së Poshtme është evidente dhe reflektojnë vepër të artit të ndonjë artisti apo shkolle shumë të mirë të kohës në fjalë.




- Fig. 180. Detaj i mozaikut të Nerodimes
- Fig. 181. Pjesë e kornizës së mozaikut të Nerodimes
- Fig. 182. Vëndndodhja e lokalitetit të Nerodimes së Poshtme



Çifllak

Lokaliteti romak i Çifllakut ndodhet në afërsi të rrjedhjes së Drinit të Bardhë në krahun e majtë të saj. Hulumtimet e zhvilluara në pjesën e parë të mileniumit tonë identifikuan gjurmë të një kompleksi të termës gjegjësisht të banjos romake me përmasa shumë të mëdha, ku ndër të tjera u dokumentuan edhe pjesë të ambientit të pishinës. Materiali i pasur arkeologjik i zbuluar këtu ka një larmi dhe tipologji të begatë të prodhimit lokal si dhe terrasigillata e importuar. Gjithashu u zbuluan vegla pune si dhe monedha, enë qelqi, fragmente arkitektonike e artefakte të tjera të përdorimit të përditshëm. Shikuar në aspektin kronologjik, ajo datohet gjatë tërë periudhës romake të shekujve II-IV e.s. sepse këtu u konstatuan dy faza ndërtimi të kohës në fjalë.



- Fig. 183. Kapitël koloneje zbuluar në Çifllak
- Fig. 184. Pamje e kuadtratit të gërmuar
- Fig. 185. Vegla pune zbuluar në Çifllak
- Fig. 186. Vëndndodhja e lokalitetit të Çifllakut



■ 187



■ 188


Nikadin

Fshati Nikadin, tashmë pothuajse paralagje e qytetit të Ferizajt, gjendet vetëm 2 kilometra në jug të saj, i pozicionuar në një tokë shumë të pllëshme bujqësore.

Gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit XX, janë evidentuar gjurmë sipërfaqësore të mbase ndonjë kompleksi të vilave romake.

Megjithatë, gjatë rregullimit të oborrit të një shtëpie në arealin e këtij lokacioni, rastësisht u zbulua një artefakt shumë i rrallë dhe mbase unik për trevën e Kosovës. Kemi të bëjmë me një kapak sarkofagu- (sarcophagus - arkivol apo arkë për vendosjen e kufomës), tërësisht nga guri gëlqeror i mermerizuar në trajtë të çatisë së shtëpisë, ku dominojnë dekorimet me motive antropomorfe (figurë njeriu) në akse dhe motive floreale në front. Ky kapak sarkofagu i përket periudhës romake fundi i shekullit III e.s. fillimi i shekullit të IV e.s.

Në vendin ku është gjetur kapaku i sarkofagut, janë zhvilluar disa sondazhe arkeologjike (2007) që rezultuan me gjurmë të një kishe me përmasa jo të mëdha ndonëse mjaft e dëmtuar, e periudhës së krishterimit të hershëm (shekujt IV-VII e.s.), e plotësuar me disa spolje (material i ripërdorur) të plastikës dekorative sepulkrale të periudhës romake (shekujt III-IV e.s.).



■ Fig. 187. Pamje ballore e kapakut të sarkofagut

■ Fig. 188. Pamje anësore e kapakut të sarkofagut zbuluar në Nikadin

■ Fig. 189. Vendndodhja e Nikadinit



Periudha e Antikitetit të Vonë dhe Mesjeta

Periudha e antikitetit të vonë gjegjësisht e njohur edhe si periudha e Bizantit të hershëm në Kosovë, fillimet e së cilës janë shenjuar me kohën e sundimit të perandorit Konstantini i Madh (vitet 306-337), përfshijnë shekujt IV-V dhe VI pas Krishtit, kohë kjo që ishte perceptuar nga historianët e antikitetit si një periudhë kalimtare apo transitore nga antikiteti në mesjetë.

Njëra nga tiparet dalluese të antikitetit të vonë është përkryerja e absolutizmit perandorak romak, si dhe ndarja e administrimit ushtarak nga administrimi civil, por mbi të gjitha ka të bëjë me krizën e sistemit antik të prodhimit dhe me rënien e Perandorisë Romake, e cila përveç krizës së brendshme u përball edhe me sulmet dhe dyndjet e barbarëve. Në lidhje me këtë kohë që qëndron dhe gërshetohet në mes të inovacioneve dhe traditës, territori i sotëm i Kosovës që dikur ishte pjesa qendrore e Dardanisë së lashtë, kalon nëpër disa ndryshime, transformime, por dhe zhvillime si në planin ekonomik, shoqëror, kulturor, religjioz e administrativ-politik.

Risia e kësaj periudhe mund të thuhet se ishte konsolidimi i krishterimit, e bashkë me të edhe lulëzimi i artit dhe i arkitekturës kristiane, ku përveç traditës së trashëguar, lind risia. Andaj arkitektura ndërtimore e kësaj kohe nga arkeologët, historianët e artit dhe historianët e arkitekturës njihet si arkitekturë e periudhës paleokristiane apo e krishterimit të hershëm. Në anën tjetër, burimet e shkruara të autorëve antikë, burimet

kishtare të arkivuara, por edhe historia orale në formën e miteve, legjendave, gojëdhënave si dhe mikrotoponimia e vendgjetjeve të qendrave arkeologjike, të gjitha këto të dhëna të regjistruara në kujtesën kolektive të banorëve të viseve të ndryshme të Kosovës, kanë ofruar dhe janë burime të rëndësishme që të sintetizuar së bashku ofrojnë dhe pasqyrojnë një tablo të përgjithshme por dhe individuale të trashëgimisë jashtëzakonisht të pasur arkeologjike të këtij regjioni të Evropës Juglindore. Tashmë Kosova nuk mund të trajtohet më si një Terra Incognita (Tokë e panjohur) por përkundrazi, dokumentimi arkeologjik i ndihmuar nga shkencat dhe disiplinat relevante shkencore, reflektojnë për një civilizim të prosperuar, të ndryshëm e kozmopolit të lashtësisë së saj.

Dëshmitë e shkruara, përveç atyre materiale, konfirmojnë prezencën e popullsisë autoktone që u shndërrua nga elementet e para shtetformuese të Mbretërisë Dardane të shekujve IV-I para Krishtit, në një provincë të Dardanisë në vitin 297 pas Krishtit, konstituuar nga vetë perandori Dioklecian, me origjinë ilire.

Periudha e antikës së vonë dhe mesjetës së hershme ishte një periudhë kohore e argumentuar edhe nga prezenca e shumë toponimeve si gjytet, gradishtë, gradinë, kala, kullë, fortesë etj. Për më tepër, këto toponime kanë kuptimin e vendbanimeve kodrinore të fortifikuar me mure rrethuese e të dokumentuara kryq e tërthor gjatë ekspeditave hulumtuese-përnjohëse dhe sondazheve sistematike në territorin e Kosovës që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe që vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Sipas burimeve të shkruara të autorit antik, Prokopi i Cezaresë, në veprën e tij “De Adificiis” (“Mbi ndërtimet”), shkruan se perandori Justiniani i Madh (527-565) me origjinë dardane nisi një program të ‘elaboruar’ të ndërtimeve dhe rindërtimeve brenda dhe përreth Dardanisë, duke u ndërtuar 8 fortesa të reja dhe u rifortifikuan 61 të tjera ekzistuese, një pjesë e të cilave edhe u rishfrytëzuan gjatë gjithë mesjetës.




Vrellë

Fshati Vrellë shtrihet rreth 7 km në perëndim të Istogut. Gërmimet arkeologjike të zhvilluara në vitin 2010 nxorën në pah një kishë paleokristiane, e shekujve IV-VI të kohës sonë me dimensione jo të mëdha. Fare pranë kësaj kishe gjendet nekropoli, i cili duhet lidhur me vendbanimin e mësipërm.

Brenda kishëzës është hasur në një varr të madh të tipit kriptë me përmasa gjatësia 2.80 m, gjerësia 1.40 m dhe lartësi e tanishme 1.40 m, e cila është e ndërtuar në formë gjysmëharku (qemer). Varri ka orientim lindje perëndim dhe është i pajisur në anën perëndimore me një portë hyrëse me lartësi të tanishme 0.6 m, po ashtu e ndërtuar në formë gjysmëharku (qemer). Varri është i ndërtuar me gurë shtufi dhe mbetje mortore të një mashkulli varrosur in takt, sipas ritit kristian, u gjetën në këtë varr.

- Fig. 190. Pamje e varrit-kriptë të kishëzës së Vrellës
- Fig. 191. Pamje e qemerit të varrit-kriptë
- Fig. 192. Mbetjet mortore të zbuluara in situ brenda varrit në kishëzën e Vrellës
- Fig. 193. Vendndodhja e lokalitetit të Vrellës





■ 194




■ 195

Banja e Malishevës

Në fshatin Banjë e Malishevës, pozicionuar në juglindje të qytezës së Malishevës, në krahun e majtë të lumit Mirushë, ndodhet lokaliteti arkeologjik i njohur me toponimin Trojet e Vjetra. Lokaliteti arkeologjik ka karakterin e një kodërvarri (tume) dhe ishte ngritur në kohën e hekurit për t'u ripërdorur në periudhën e mesjetë së hershme.

Hulumtimet, gjegjësisht gërmimet arkeologjike të zhvilluara në këtë sit arkeologjik në vitin 2005, dëshmuuan gjurmë të varreve me konstruktion të pllakave të gurit dhe nga inventari i pasur arkeologjik, spikatin disa stoli tipike për mesjetën e hershme si unaza bronzi, byzylykë dhe disa varëse qafe me simbolin e kryqeve kristiane.



- Fig. 194. Pamje e pjesshme e gërmimit të zhvilluar në kodërvarrin e Banjës së Malishevës.
- Fig. 195. Unaza bronzi me mbishkrim dhe kryqe bronzi për varëse qafe
- Fig. 196. Vendndodhja e lokalitetit të Banjës së Malishevës
- Fig. 197. Pamje ajrore e lokalitetit të Banjës së Malishevës



■ 198

■ 199

Kalaja e Harilaqit


Kalaja-fortesa e Harilaqit (shek. IV-VI) gjendet mbi një kodër të njohur si *Gradina e Harilaqit*, e ngritur në një pozitë mjaft dominante, në perëndim të fshatit Harilaq, në lartësinë mbidetare prej maksimum 766 metra mbi nivelin e detit dhe ndodhet rreth 9 km në juglindje të Fushë - Kosovës dhe vetëm dy kilometra në perëndim të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës “Adem Jashari”. Kalaja kap një sipërfaqe të rrethpërkthuar me mure mbrojtëse prej rreth 1.3 hektari.

Gërmimet arkeologjike në këtë kala kanë filluar në vitin 2005 dhe kanë vazhduar sistematikisht deri në vitin 2010, por janë kryer edhe disa konservime dhe konsolidime të mureve me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së saj. Gjatë gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në gjashtë sezona kanë dalë në pah gjurmë të shumta të rrënojave të objekteve sakrale, profane dhe utilitare, si: tërë faqja e jashtme e murit rrethues të kalasë me kullat në akse, pastaj kisha me tri nefe dhe sakristi, si dhe dy struktura pothuajse identike në formë unazore të një kompleksi sakral. Gjithashtu material i bollshëm i lëvizshëm arkeologjik si vegla pune, stoli, monedha, tulla, fragmente qelqi dhe struktura arkitektonike që posaçërisht theksojnë periudhën e antikitetit të vonë, e në veçanti atë të kohës së Justinianit.

Gjithashtu në këtë kala ka indikacione edhe të periudhave parahistorike, e në veçanti të kohës së metaleve, antikës e mesjetës, si dëshmi e vazhdimësisë së jetës në kala.



■ 200




■ Fig. 198. Pamje e kodrës së Harilaqit

■ Fig. 199. Pamje e disa kuadrateve brenda kalasë

■ Fig. 200. Foto ajrore e kalasë së Harilaqit

■ Fig. 201. Vendndodhja e kalasë së Harilaqit



Kalaja e Pogragjës

Kalaja e Pogragjës gjendet në fshatin me të njëjtin emër, e pozicionuar në grykën e Llapushnicës dhe ka lartësi mbidetare prej 567 m. Kalaja pozicionohet vetëm 10 kilometra në juglindje të Gjilanit dhe poshtë të këmbët e kodrës rrjedh lumi i Moravës së Binçës. Planimetria e citadelës së kalasë të Pogragjës, ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt, ndërsa muri jugor i kullës qendrore ka rolin e murit mbrojtës të citadelës.

Në pjesën më të lartë ruhen gjurmët e një kulle vështuese, muret e së cilës shkojnë deri në dhjetë metra lartësi dhe e cila ka trajtë katrore me dimensione simetrike 8 metra me 8. Gjithashtu, në pjesët e akseve të kësaj forte, gjenden kullat me dimensione më të vogla, të vendosura si në pjesën perëndimore, veriore dhe verilindore, si dhe vende-vende ruhen akoma në lartësinë prej afër 4 metrash. Fortesa ka një sipërfaqe të brendshme prej 1.2 hektarësh dhe është tipike për kohën e Justinianit (shek.VI), respektivisht bën pjesë në kuadr të rrjetit të fortifikatave të ngritura në Dardani nga fundi i antikitetit të vonë.

- Fig. 202. Muret ekzistente të citadelës së kalasë së Pogragjës
- Fig. 203. Pjesë të shkallareve brenda murit rrethues të kalasë
- Fig. 204. Pamje nga largësia e kalasë së Pogragjës
- Fig. 205. Vendndodhja e lokalitetit të Pogragjës

Kalaja e Korishës me Kishën Paleokristiane


Gërmimet arkeologjike të zhvilluara në vitin 2002 dhe 2004 në kodrën e kalasë së Korishës, e njohur me mikrotoponimin Gralishta, nxorën konturrat dhe u dokumentua planimetria e një kishe paleokristiane të shekullit VI. Kisha në fjalë gjendet brenda arealit të brendshëm të fortesës dhe ka një absidë të orientuar drejt lindjes. Po në këtë pjesë u evidentuan gjurmë të sintronit të konstruktuar në formë të shkallëzuar e në trajtë trapezi. Në kuadër të hapësirës së altarit u evidentuan edhe pjesë të kangjelës.

Sa i përket materialit të lëvizshëm arkeologjik, këtu dolën në dritë disa fragmente enësh qeramike të datimit prehistorik me siguri që lidhen me lokalitetin përballë të periudhës së bronzit të mesëm, si dhe fragmente të enëve të ndryshme si amfora, pitosa, vorba, kana etj të datimit të fundit të antikitetit të vonë, shek. VI.

■ Fig. 206. Pamje nga distanca e kalasë së Korishës

■ Fig. 207. Pamje fotografuar nga lindja, e kishës paleokristiane të Korishës, brenda kalasë

■ Fig. 208. Vendndodhja e kalasë së Korishës






■ 210

■ 209

Kalaja e Kastercit

Lokaliteti arkeologjik i tipit fortifikatë në Kasterc, i pozicionuar rreth 12 kilometra në veriperëndim të Suharekës (Therandës) respektivisht i njohur edhe si Hisari i Kastercit, është dëshmuar të jetë një qendër arkeologjike shumëshiresore duke vazhduar shfrytëzimin që nga kohërat parahistorike, më saktësisht nga një vendbanim i mbrojtur eneolitik, e më pas riformësohet në një fortifikatë të kohës së perandorit Justinian dhe për t'u ripërdor si një varrezë gjatë kohës së mesjetës.


Në këtë lokalitet arkeologjik, hulumtimet e para me karakter sondazhi arkeologjik janë zhvilluar në vitin 1986, duke nxjerrë një pasqyrë të përgjithshme. Hulumtimet arkeologjike vazhduan edhe gjatë vitit 2010 dhe 2011 duke zbuluar një sipërfaqe prej rreth 500 metrash katrorë dhe nxorën në dritë një kishë paleokristiane dhe material të veçantë të luajtshëm arkeologjik, në përbërje si vegla pune prej hekuri, keramikë, stoli, vathë, unaza, byzylykë, monedha etj.



■ Fig. 209. Pamje nga distanca e Hisarit të Kastercit

■ Fig. 210. Ortofoto e Hisarit të Kastercit

■ Fig. 211. Vendndodhja e Hisarit të Kastercit




■ Fig. 212. Vëndndodhja e Kalasë së Vuçakut
■ Fig. 213. Pamje e kodrës së Kalasë së Vuçakut

Kalaja e Vuçakut

Në fshatin Vuçak rrëzë malit Kasmaç, rreth 12 km në jugperëndim të Drenasit, e vendosur në një pozitë shumë dominuese, vërehen gjurmët e rrënojave të mureve që përcjellin konfiguracionin e kodrës dhe formojnë Gradinën e Madhe (*Gjyteti i Madh*) dhe Gradinën e vogël (*Gjyteti i Vogël*). Duke u mbështetur në materialin arkeologjik që është gjetur këtu, janë dëshmuar gjurmë që nga parahistoria e deri te mesjeta. Megjithatë, kjo kala ishte tipike për kohën e antikitetit të vonë dhe shërbente si sistem mbrojtës për popullatën vendase.

Kalaja e Strocit

Në fshatin Stroc gjendet kalaja e njohur me emërtimin Gradina, lokalitet ky arkeologjik me indikacione të shfrytëzimit që nga parahistoria, antika e vonë dhe mesjeta e hershme. Në shpatet e kodrës, vërehen mure të vendosura në formë të kaskadave, që shkojnë deri lart në majë të kodrës. Këtu edhe në ditët e sotme, vërehen gjurmët e kullave dhe bedenave apo mureve rrethuese të kësaj forte, me trashësi deri në 2 metra. Sipas konfiguracionit të terrenit dhe gjurmëve të evidentuara, supozohet se këtu gjendej një objekt me karakter kulti që mbase u ka shërbyer banorëve të saj lokalë.



■ Fig. 214. Vëndndodhja
■ Fig. 215. Pamje e kodrës të Kalasë së Strocit




Fig. 216. Vëndndodhja e kalasë së Llapushnikut.
Fig. 217. Pamje e kodrës së Llapushnikut.

Kalaja e Llapushnikut

Shtrihet rrzë majave të maleve të Drenicës, në jug të Grykës së Llapushnikut, rreth 10 km në jugperëndim të qendrës komunale të Drenasit. Kalaja e Llapushnikut kishte një mur kështjellar me dimensione rreth 200 me 300 m. Muri ka pasur trashësi mbi 2 metra dhe kishte kulla. “Kulla e Kalasë” ka dimensione 10 x 10 m. Në tërë lokalitetin janë të pranishme tullat dhe tjegullat të periudhës së vonë antike.


Kalaja e Llanishtës

Rreth 1 km në jug të Kaçanikut, në pjesën e ngritur në lartësinë prej 684 metrash mbi nivelin e detit, në lokalitetin Vranjak janë identifikuar rrënoja të një forte ku dallohet qartë muri i trashë rreth 1.7 m, me lartësi relative 2.5-3m (të ruajtur), të punuar nga gurët e terrenit të pagdhendur dhe të lidhur me llaç gëlqeror. Muri i punuar është vendosur mbi shkëmbin natyror. Kurse lart në kodër, muri ruhet deri në 50-60 m gjatësi, linja këto që ndjekin izohipsat e kodrës. Përmes një qafe të butë, komunikon me fshatin e Llanishtës.

Fig. 218. Foto e një trakti muri të kalasë

Fig. 219. Vëndndodhja e kalasë së Llanishtës





221

Fig. 220-221. Vendndodhja dhe pamje e kodrës të Kalasë së Dubocit.


Kalaja e Dubocit

Në aspektin arkeologjik, kalaja e Dubocit, e pozicionuar mbi kodrën e Çeçanit, pjesë e vargmalit të Çiçavicës jo larg Vushtrrisë, më së miri e tregon dëshminë më të vjetër të fortifikimit të periudhës së antikitetit të vonë. Muret rrethuese që e rrethpërkrahin fortesën në fjalë, kornizojnë gjurmë të objekteve dhe ambienteve akoma të pa gërmuara.

Kalaja e Topanicës

Kalaja e Topanicës pozicionohet rreth 50 metra në veri të krahut të majtë të rrugës që lidh fshatin Topanicë me fshatin Domorovc. Kjo fortesë ndodhet në lokalitetin e njohur me mikrotoponimin Te Popovca. Sipas të dhënave më të hershme, gjatë punimit të tokës, gjithnjë kanë dalë gjurmë të eshtrave, fragmente tullash e tjegullash etj. Kjo fortifikatë gjendet vetëm 100 metra në perëndim të Gravecit të Topanicës, lokalitet ky shumëshpresor arkeologjik. Gjithashtu komunikon me fortesat e tjera përreth si Graveci i Hodanovcit dhe Graveci i Domorovcit, në lindje dhe juglindje të saj. Të gjitha këto fortesa të vogla kanë pasur një rol të mbikëqyrjes së rrugëve vicinale dhe si të tilla dominonin me pozitat e tyre të ngritura mbi këto rrugë.

Fig. 222-223. Vendndodhja dhe pamje e kodrës të kalasë së Topanicës



223




■ 224

Suka e Cërmjanit

Mbi një kodër të lartë rreth 500 metër mbi nivelin e detit, në pjesën veriore të fshatit Cërmjan, me një pozitë dominuese gjeostrategjike, pozicionohet Suka e Cërmjanit një vend gjetje arkeologjike njohur dhe si Kështjella e Cërmjanit. Muret e saj përcjellin izohipsat e konfiguracionit të terrenit shkëmbor në një sipërfaqe prej rreth 1.3 hektarë.

Kështjella e Sukës së Cërmjanit i ka të gjitha tiparet e një vendbanimi të fortifikuar të Antikitetit të Vonë, por në bazë të dokumentimit arkeologjik, aty është dëshmuar vazhdimësia e jetës që nga Periudha e Hekurit e deri te Periudha e Mesjetës së Hershme. E veçanta e kësaj kështjelle është komunikimi vizual me; Kështjellën e Dollcit dhe kështjellën e Jerinës së Pogradit të Klinës në veri, me kështjellën e Radacit dhe të Jabllanicës së Pejës në veriperëndim, qyteti i Gjakovës shihet në horizont drejt jugperëndimit, fortesa e Zatriqit të Rahovecit shihet në verilindje-lindje, si dhe drejt jugut shfaqen peizazhet e kodrinave dhe fushave të cilat shkojnë deri tek këmbët e bjeshkës së Pashtrikut.



■ Fig. 224. Pamje nga distanca e kodrës së Sukës së Cërmjanit.

■ Fig. 225. Ortofoto e Sukës së Cërmjanit.

■ Fig. 226. Vendndodhja e Sukës së Cërmjanit.



■ 227


Rrënojat e vendbanimit të ngritur e të fortifikuar që nga Periudha e Hekurit e me intensitet të madh banimi posaçërisht gjatë Antikitetit të vonë e Mesjetës së hershme të ‘Gradishtës’ së Zatriqit, ndodhen në majën e kodrës së Zatriqit, me kuotë maksimale prej 1039 metër mbi nivelin e detit. Ky ‘qytet fortesë’ e tipit të vendbanimeve shumë shtresore, është ngritur në një linjë perimetrike që ndjek izoipset e terrenit duke shfrytëzuar dhe mbrojtjen natyrore që ishte integruar natyrshëm në sistemin mbrojtës të saj.

Në të gjithë sipërfaqen e fortifikuar, si edhe në “Arat e Gradishtës”, që gjenden të taracuara pranë fortesës, janë dokumentuar fragmente enësh prej argjilës së pjekur, këto të periudhave të ndryshme si; Hekurit, Helenistike, Antike të Vonë e Mesjetare. Megjithatë, e veçanta e kësaj qendre arkeologjike me karakter fortifikues qëndron në faktin e identifikimit nga specialist Italian të Artit Shkëmbor të kohërave të lashta parahistorike këto të pasqyruara në shenja dhe simbole që vlersohet të jenë krijuar nga dora e njeriut shtatë mileniume më parë.

Zatriq



■ 228




- Fig.227. Pamje e kodrës të Kalasë së Zatriqit
- Fig.228. Ortofoto e kodrës së Zatriqit
- Fig. 229.Vendndodhja e Kalasë së Zatriqit



■ 230

Kalaja e Veletinit

Fortesa e Veletinit, ndodhet rreth pesë kilometër në juglindje të lokalitetit arkeologjik të Ulpianës, dhe rreth 1.5 kilometër në veriperëndim të Janjevës, e pozicionuar në pjesën kodrinore të fshatit Shashkoc që është një 'ishull' në kuadër të Komunës së Prishtinës, ndonëse fizikisht nuk bënë pjesë në të. Kalaja gjendet mbi kodrën Veletin dhe lartësia e saj maksimale kap kuotën prej 970 metër mbi nivelin e detit. Pozita gjeostrategjike e vendndodhjes së kalasë, me shikim drejtë minierave antike në pjesën lindore të saj, dhe në anën tjetër, pozita e qartë vëzhguese në krahun perëndimor që tërësisht komunikon me Ulpianën që gjendet në një rrafsh, e bënë këtë fortesë, një pikë shumë të rëndësishme të tërë këtij areali arkeologjik.



Gërmimet e zhvilluara arkeologjike gjatë viteve të tetëdhjeta, rezultuan me faktin se kalaja kishte qenë e shfrytëzuar që nga periudhat më të hershme të eksploatimit të xeheve e të shkrirjes së metaleve dhe në vazhdimësi ishte ripërdorur dhe rindërtuar gjatë tërë periudhave kohore si; parahistorike, romake, antike e vonë e Mesjetare.

- Fig. 230. Pamje nga distanca e Veletinit
- Fig. 231. Ortofoto e kodrës.
- Fig. 232. Vendndodhja e kalasë së Veletinit

Graboc



233




234

Lokaliteti arkeologjik i Grabocit të Ulët ndodhet prane vendbanimit eponim, buzë lumit Drenicë, afër 10 km në perëndim të Fushë-Kosovës. Në lagjen e Berishëve, në vendin e njohur me emrin *Bahçe*, fillimisht në vitin 2004 e më pas edhe në disa fushata gërmimi, janë evidentuar gjurmë të një varreze me inhumacion të kohës së mesjetës së hershme.

Këtu janë evidentuar dhjetëra varre, pjesa më e madhe e të cilave ruanin skelete në gjendje të mirë, me përjashtim të dy varreve që u mungonte kafa. Orientimi i skeleve ishte perëndim-lindje (d.m.th. koka në perëndim, kurse këmbët në lindje). Gjithashtu u mbledh edhe një material i konsiderueshëm i fragmenteve të qeramikës së glazuar mesjetare si dhe janë gjetur edhe disa fragmente të qeramikës parahistorike.

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen është se inventari i varreve të kulturës arbërore përbëhet kryesisht nga stoli, armë, vegla pune, qeramikë dhe shumë më rrallë enë qelqi. Nga inventari veçohen stollitë, të cilat përbëjnë një larushi objektsh. Gjetjet më me vlerë janë unaza bronzi, byzylkë, një monedhë që kishte një vrimë (mbase është përdorur në varëse) por dhe vathë të granuluar, edhe këto prej bronzi.



- Fig. 233. Pamje e disa varreve zbuluar në Graboc të Ulët
- Fig. 234. Moment pune gjatë zbulimit të një varri.
- Fig. 235. Byzylukë dhe unazë si inventar varri.
- Fig. 235a. Byzylukë dore dhe vathë zbuluar në varret e mesjetës së hershme të Grabocit
- Fig. 236. Vendndodhja e nekropolit mesjetar



■ 237




■ 238

Matiqan

Punimet filigraniste në arë e argjend, me gurë dekorativë e të çmuar si dhe me motive të llojllojshme me imitime bizantine me siguri prezantojnë punimet e ndonjë punëtore vendore, e cila flet shumë për aftësitë krijuese, artizanale e artistike të argjendarëve lokalë, por në anën tjetër edhe reflekton për një mirëqenie dhe status të lartë ekonomik e social të të ndjerëve të varrosur aty. Përveç inventarit të pasur arkeologjik që janë artefakte me vlerë të madhe të papërcaktuar, një dëshmi të madhe në aspektin e dokumentimit të antropologjisë fizike kanë ofruar mbetjet kockore (skeletore) të personave të varrosurve aty.

Dikur fshati Matiqan, sot paralagje e Prishtinës, është i njohur në literaturën arkeologjike me rastin e evidentimit dhe dokumentimit të një nekropoli në pjesën e njohur si Matiqan i Poshtëm, i cili në bazë të kulturës materiale dhe kronologjisë arkeologjike datohet diku mes shekujve X-XI. Nekropoli i veçantë në fjalë dëshmon mbetjet mortore, varre në të cilat ishte varrosur popullsia autoktone e krishterë. Inventari i pasur dhe i shumëllojshëm arkeologjik spikatet nga objekte të ndryshme zbukuruese të bizhuterisë dekoruese femërore të cilësisë së lartë, si në punim, ashtu dhe në material, dëshmi këto të një të kaluarë të begatë në këtë trevë.



■ 240



■ 239

- Fig. 237. Vendndodhja e varrezës mesjetare të Matiqanit.
- Fig. 239. Unazë argjendi zbuluar në varrezën mesjetare të Matiqan
- Fig. 238. Vathë të flakëruar në ar dhe të zbukuruar me gurë të çmuar
- Fig. 240. Vathë argjendi zbuluar në Matiqan.

Novobërdë




Në një mal të vogël ndërmjet Përlepnicsës dhe Krivarekës, rreth 30-35 km në perëndim prej Gjilanit dhe rreth 39 kilometra në jug-lindje të Prishtinës, ruhen rrënojat e qytetit dhe fortesës mesjetare të Novobërdës. Sipas dokumenteve të zbuluara deri më sot, Novobërda me këtë emër për herë të parë përmendet në dekadat e para të shekullit XIV, me emërtimin Nuovo Monte.

Qyteti mesjetar ishte një vendbanim xehetar dhe në ditët e sotme janë ruajtur pjesë të mureve, kullave mbrojtëse, si dhe gjurmë të themeleve të disa monumenteve sakrale të arealit të fortesës.

Fortesa përbëhet nga qyteti i epërm dhe qyteti i poshtëm, ndërtuar mbi kodrën e Novobërdës. Qyteti i poshtëm, gjegjësisht Nënkalaja, shtrihet në kodra, në lindje dhe juglindje tërësisht deri te miniera nën Malin e Madh. Qyteti i epërm është ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës, ndërkaq nën të, në drejtim të perëndimit, shtrihet qyteti i poshtëm me bazë në formë të freskores.

Qyteti ka qasje vetëm nga pjesa lindore. Nga pjesët e tjera, pjerrësia e kodrës është shumë e rrëpirët në drejtim të luginës. Në pjesën lindore, terreni ngrihet gradualisht dhe kalon në një kodër tjetër më të vogël, në platonë e epërme, nën të cilën gjenden rrënojat e një kishe të madhe mesjetare të tipit katedrale.



- Fig. 241. Pamje e kodrës të kalasë së Novobërdës
- Fig. 242. Foto ajrore e kalasë së Novobërdës
- Fig. 243. Vendndodhja e kalasë së Novobërdës



■ 244

■ 245



Kalaja e Prizrenit

Qyteti historik i Prizrenit, i veçantë si në vendndodhje, strukturë banimi dhe arkitekturë vernakulare, në mesin e dhjetëra monumenteve të kulturës spikat edhe për kalanë unike që gjatë kohëzgjatjes shumëshekullore të ekzistencës së saj, bart gjurmë të shumta dhe evidente të trashëgimisë së larmishme kulturore nga lashtësia e deri më sot. Vetë pozita e jashtëzakonshme gjeostrategjike, integritetit strukturor i saj, horizonti i gjerë i vështrimit, të gjithë këta faktorë që dëshmojnë vlerat monumentale të kësaj tërësie kulturore.

Kështjella e kalasë së Prizrenit pozicionohet në një kodër dominante në anën lindore të qytetit të Prizrenit, në një pozitë strategjike, duke i përcjellë cilësitë dalluese morfologjike të terrenit natyror.

Gërmimet arkeologjike të bëra më 1969 dhe sërish në vitet 2004, 2009-2011, rezultuan me zbulimin e infrastrukturës, e cila prezantohet me muret (bedenat) të përforcuara me kullat, kazamatet, labirintet,



■ Fig. 244. Pamje ajrore e kalasë së Prizrenit

■ Fig. 245. Pamje nga largësia e kalasë së Prizrenit

■ Fig. 246. Vendndodhja e kalasë së Prizrenit



■ 247



■ 248

depot si dhe një varg objektesh në brendinë e saj.

Në aspektin ndërtimor ndahet në tri komplekse të veçanta që njihen si Qyteti i Epërm, Qyteti i Poshtëm dhe Qyteti Jugor, ndërsa në aspektin e fortifikimit ndër shekuj, ajo u përket periudhave të ndryshme si periudha antike, periudha e sundimit bizantin, ajo mesjetare dhe periudha e sundimit të Perandorisë Osmane. Kalaja e Prizrenit është njëra ndër monumentet më kapitale të trashëgimisë kulturore historike të Kosovës dhe njihet si një muze i hapur.



■ 249



■ 250

- Fig. 247. Foto brenda kalasë
- Fig. 248. Pamje nga distanca e kalase
- Fig. 249. Porta kryesore e kalasë
- Fig. 250. Pamjet e kazamateve të kalasë




■ 251

Muzeu i Kosovës

Muzeu i Kosovës është institucioni më i hershëm i trashëgimisë kulturore i themeluar me qëllim të ruajtjes, restaurimit-konservimit dhe prezantimit të trashëgimisë të luajtshme arkeologjike për territorin e Republikës së Kosovës. Institucioni i Muzeut të Kosovës është vendosur në një objekt të veçantë, si në arkitekturë, ashtu dhe në vendndodhje, gjegjësisht gjendet në bërthamën e vjetër të qendrës së qytetit. Në fakt, Muzeu i Kosovës ekziston që nga viti 1949, megjithatë objekti i Muzeut u ndërtua në vitin 1889 dhe ishte projektuar sipas stilit të ndërtimit të ashtuquajtur austro-hungarez dhe në të vërtetë kishte si destinim vendosjen e komandës së lartë ushtarake të kohës.

Muzeu përbëhet prej 3 sallave apo galerive nga të cilat njëra shërben si sallë e ekspozitës së përhershme arkeologjike, por ekspонатet janë të prezantuara edhe në oborrin e brendshëm të Muzeut si dhe në lapidariumin gjegjësisht Parkun Arkeologjik që ndodhet përkrah ndërtesës së Muzeut, në krahun e djathtë të saj. Poshtë Muzeut, në bodrumet e tij, gjenden ambientet e depove të mijëra gjetjeve, artefakteve dhe fragmenteve të luajtshme të materialit arkeologjik, të cilat janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të veçanta dhe me kujdes të posaçëm.


Në ndërtesën e Muzeut të Kosovës, respektivisht në katin e tretë të saj, gjenden ambientet e punës të Institutit Arkeologjik të Kosovës, institucion ky shkencor-profesional dhe kompetent për hulumtimet arkeologjike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.





■ Fig. 251. Muzeu i Kosovës.

■ Fig. 252. Në të djathtë të rrugës, lapidariumi i muzeut.

■ Fig. 253. Pjesë e ekspozitës arkeologjike








Republika e Kosovës

Legjenda

- Kufij shtetërorë
- Kufij administrativë
- Kryeqytet
- Qytet
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"
- Autostrada "Ibrahim Rugova"
- Rrugë magjistrale
- Rrugë dytësore
- Hekurudhë
- Lum
- Liçen









Lokalizimet e Periudhës Eneolitike

Legjenda

1. Gadime e Epërme
2. Hisar
3. Veletin
4. Domorovc
5. Stanishor
6. Raskovë
7. Glladnicë
8. Vlashnje
9. Karagaç
10. Fafos







Lokalitetet e Periudhës së Bronzit

Legjenda

1. Rixhevë – Gllarevë
2. Boka e Përçevës
3. Rogovë
4. Korishë
5. Bërnice e Poshtme
6. Ponoshec
7. Karagaç
8. Lushhtë
9. Glladnicë
10. Varosh
11. Grashticë
12. Ulpianë
13. Teneshdoll







Lokalizimet e Periudhës së Hekurit

Legjenda

1. Boka e Përçevës
2. Rogovë
3. Bërnice e Poshtme
4. Ponoshec
5. Gjinoc
6. Bellaçec (Bardh i Madh)
7. Fshej
8. Llashticë
9. Shirokë
10. Lubozhdë
11. Banjë e Pejës
12. Gadime e Epërme
13. Hisar
14. Romajë
15. Kulinë
16. Teneshdol
17. Biti e Poshtme
18. Samadrexhë







Lokalitetet e Periudhës Romake

Legjenda

1. Municipium DD (Soçanicë)
2. Vindenis (Gllamnik)
3. Pestovë
4. Poslishtë
5. Staradran
6. Cërcë
7. Vërban
8. Paldenicë
9. Municipium Ulpiana (Graçanicë)
10. Statio Viciano (Uglar)
11. Nerodime e Poshtme
12. Çifllak
13. Nikadin
14. Sopotninë
15. Zllakuçan
16. Ish-Fabrika e baterive (Pejë)
17. Municipium i panjohur (Dërsnik)
18. Velekinçë
19. Gushtericë e Poshtme
20. Zaskok
21. Banjicë
22. Çollopek
23. Dobratin
24. Sopi
25. Kotlinë
26. Rastavicë
27. Tushilë
28. Ticë
29. Jahoc





Lokalizimet e Periudhës të Antikës së Vonë dhe Mesjetës

Legjenda

1. Vrellë
2. Banja e Malishevës
3. Kalaja e Harilaqit
4. Kalaja e Pogragjës
5. Kalaja e Korishës
6. Kalaja e Kastërcit
7. Kalaja e Vuçakut
8. Kalaja e Strofçit
9. Kalaja e Llapushnikut
10. Kalaja e Llanishtës
11. Kalaja e Dubocit
12. Kalaja e Topanicës
13. Suka e Çermjanit
14. Zatriq
15. Veletin
16. Graboç i Ulët
17. Matičan
18. Kalaja e Novobërdës
19. Kalaja e Prizrenit
20. Çercë
21. Ulpiana (Justiana Secunda)
22. Nerodime e Poshtme
23. Nikadin
24. Jahoc
25. Anina
26. Çeçan
27. Gjyteti i Rahovecit
28. Bellacërk
29. Gradina e Janjevës
30. Kalaja e Gërnaçarit
31. Kalaja e Kamenicës

